



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Program i studimit i Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në  
“Stomatologji”  
Kolegji Universitar “REALD”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Gazment KODUZI**

**Prof. Asoc. Dr. Teuta PUSTINA – KRASNIQI**

**Tetor / 2023**





## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Program i studimit i Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Stomatologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi i Integruar “Master i Shkencave” në “Stomatologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 259, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike / 10 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip / Italisht *
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	25 PAE dhe 2 PAK Për sa i përket ngarkesës mësimore 94% PAE- 6 % PAK
18	Numri i studentëve:	2018-2019 – 10 studentë 2019 – 2020 – 2 studentë 2020 – 2021 – 0 studentë 2021 – 2022 – 63 studentë 2022 – 2023 – 76 studentë

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



19	Komente / të tjera:	
----	---------------------	--

\* Në bazë të Urdhërit të MAS Nr. 483, datë 29.08.2023, programi i studimit ofrohet edhe në gjuhën italiane.

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Qeveria Shqiptare përmes VKM Nr. 650 datë 14.09.2011 “Për licensimin e Akademisë së studimeve të aplikuara “REALD”, lejoi ngritjen e Akademisë së Studimeve të Aplikuara “REALD” të përbërë nga 2 (dy) fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Ekonomisë. Kolegji Universitar “REALD” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 93, datë 20.10.2017 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Kolegji Universitar “REALD”, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 19.10.2022.



Programi i studimit i Integruar “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, është licensuar fillimisht sipas VKM Nr. 650 datë 14.09.2011, që do të realizohej me 300 kredite, dhe kohëzgjatje 5 vite akademike. Me Urdhër Nr. 457 datë 27.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, programi i studimit i Integruar “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, është riorganizuar në masën 20%, në program të përbashkët studimi në “Stomatologji dhe Proteza Dentare” me Universitetin e Foggias në Itali, në gjuhë shqipe / italiane, me formë studimi me kohë të plotë, me 360 kredite, me kohëzgjatje normale 6 vite akademike, 12 semestra, ku në fund të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji dhe Proteza Dentare”, nga Kolegji Universitar “Reald” dhe Universita degli Studi di Foggia. Universiteti i Foggias nuk firmosi protokollat ekzekutive brenda afatit, bazuar në marrëveshjen dypalëshe, dhe si rrjedhojë për 2 vjet rresht nuk janë regjistruar studentë në këtë program studimi.

Si rrjedhojë, me Urdhër Nr. 259, Datë 19.07.2021 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji dhe Proteza dentare”, u riorganizua në program të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, në Kolegjin Universitar “REALD”, me 300 kredite me kohëzgjatje 5 vite akademike, në gjuhën shqipe me kohë të plotë.

Programi i studimit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, i cili përbëhet nga 4 njësi bazë:

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



1. **Departamenti i Stomatologjisë;**
2. Departamenti i Farmacisë;
3. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore;
4. Departamenti i Veterinarisë;

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në datën 24.02.2022, Kolegji Universitar "REALD" ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Stomatologji". Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur bazuar në VKM Nr.824, datë 14.12.2021, "PËR MIRATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË".

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Asoc. Gazmend Koduzi** dhe **Prof. Asoc. Teuta Pustina-Krasniqi**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Majlinda Demirneli**.

Ky proces u parapri nga vlerësimi i dokumentacionit të dërguar nga institucioni në sistemin AMS të ASCAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në institucion në datat 12-13 Qershor 2023. Gjatë vizitës në institucion u kryen takime me:

- Dekanin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;
- Përgjegjësin e Departamentit të Stomatologjisë;
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Stafin akademik të angazhuar në programet e studimit;
- Studentët e programit të studimit Msc në Stomatologji;
- Përfaqësues të Zyrës së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Përfaqësues të Qendrës Kërkimore;
- Përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.

Pjesë e axhendës së vizitës ishte edhe vëzhgimi i mjedisëve ku zhvillohet programi mësimor (auditorët, laboratorët) si dhe vizitë në bibliotekë. Në përfundim të vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm, u takua me përgjegjësit e departamenteve dhe i bëri një rezymë të vizitës. Vlen të theksohet, që grupi i vlerësimit të jashtëm gjeti bashkëpunim të plotë nga përfaqësuesit e Kolegjit Universitar "REALD" për çdo pyetje apo dokumentacion të kërkuar. Ambienti i vendosur në dispozicion të GVJ mundëson kryerjen e procesit dhe të takimeve me grupet e punës, sipas agjendës së përgatitur.

Kolegji Universitar "REALD" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 141/26 Prot,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



datë 13.09.2023. Kolegji Universitar “REALD” më datë 18.09.2023, njofton, me anë të shkresës me Nr.388 Prot, datë 14.09.2023 “Dërgojmë komentet tona lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## **Vlerësimi i Programin e Integruar i Nivelit të Dytë në “Master i Shkencave në Stomatologji”**

### **I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar REALD ofron programe të licensuara nga Ministria e Arsimit, në përputhje me interesat kombëtare, të cilat synojnë aftësimin e studentëve dhe rritjen e mundësisë të punësimit të tyre në fushën e stomatologjisë, duke u siguruar studentëve një bazë të fortë teorike dhe praktike të shërbimit mjekësor dentar, dhe duke i përgaditur që të jenë të aftë të punojnë si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, në Shqipëri apo jashtë saj.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit i integruar i ciklit të dytë në “Stomatologji” është i hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar REALD /KUR/, të përcaktuar në Statutin e tij, miratuar me Vendim nr. 56, datë 07.12.2016 të Senatit Akademik, dhe Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Neni 4 “Qëllimi dhe misioni i Kolegjit Universitar REALD”. Kolegji Universitar “REALD” e ofron programin e studimit të integruar të ciklit të dytë në “Stomatologji” që prej themelimit të tij me VKM 650 datë 14.9.2011, dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<i>(Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit)</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	<p>Programi i integruar i studimit cikli dytë në “Stomatologji” është i hartuar dhe ofrohet në përshtatje me dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim 2021 – 2026 të Kolegjit Universitar “REALD”, miratuar me Vendim nr. 6, datë 02.06.2020 të Bordit të Administrimit; Statutit të KUR, miratuar me Vendim nr. 56, datë 07.12.2016 të Senatit Akademik, dhe Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit; si dhe Rregullore e KUR, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 3. Strategjia e zhvillimit 2021 – 2026 miratuar me Vendim nr. 6, datë 02.06.2020 të Bordit të Administrimit; (Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit; Evidenca nr.4. Rregullore e KUR, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik .)</i></p>		
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Programi i integruar i studimit cikli dytë në “Stomatologji”, është i hartuar në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të MASR dhe në planin strategjik të IAL Kolegji Universitar “REALD”. Aktualisht, ka një prirje në rritje të turizmit dentar në vend dhe kjo paraqet një kërkesë të tregut për rritje të numrit të profesionistëve të stomatologjisë.</p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Kolegji Universitar “REALD” ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të KUR, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Kolegji Universitar “REALD” që prej themelimit të tij bazuar në VKM Nr. 650 datë 14.9.2011 “Për licensimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara “REALD”, ka pjesë të tij Fakultetin e Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programin e integruar të studimit cikli dytë në “Stomatologji”, çfarë tregon që ka përvojën e duhur.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 61 pedagogë, nga të cilët 48 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

*(Evidenca nr. 85. Tabelat permbledhese per Anels-RVB per programin Bachelor ne Infermieri)*

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	1
Prof.Asoc	-	2
Dr/PhD	18	6
Msc	27	4
<b>Gjithsej</b>	<b>48</b>	<b>13</b>

Ndërsa Departamenti i Stomatologjisë, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Stomatologjisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.Asoc	-	-
Dr/PhD	5	5
Msc	8	1
<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>6</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabh...*

*Q...*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	Gjithashtu, KUR ka burimet e duhura logjistike për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore, përmes laboratorëve të anatomisë humane, laboratorit dentar për seminare, klinikën stomatologjike me 5 poltronë për praktikë, si dhe praktikatat e nevojshme përmes kontratave me klinika stomatologjike private.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i integruar i studimit të ciklit dytë në “Stomatologji” ofrohet bazuar në përcaktimet për emërtimin, organizimin dhe strukturën në Ligjin Nr.80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, Neni 20, Statutit të KUR, dhe Rregullores së Studimit. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë në “Stomatologji” bën pjesë në nivelin e 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, është emërtuar sipas fushës së studimit në Programin e Integruar të studimit të ciklit dytë në “Stomatologji”. Fusha e përgjithshme e studimit është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, ndërsa fusha specifike është në përputhje me njësinë bazë – Departamentin e Stomatologjisë.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e studimit të ciklit dytë në “Stomatologji” është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, ndërsa fusha specifike është në përputhje me njësinë bazë – Departamentin e Stomatologjisë.
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	<b>Nuk përputhet me programin në akreditim</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për	Kolegji Universitar “REALD” ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në stomatologji, në

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	bashkëpunim me institucione ndërkombëtare, si Maco Dental Care për implantologjinë. (Evidenca nr. 26. Programi i seminarit të implantologjisë)		
<b>Konkluzione</b>	Programi i studimit MSc në Stomatologji është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion, Departamenti i Stomatologjisë.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi i integruar i studimit cikli dytë në “Stomatologji”, ofruar nga Kolegji Universitar “REALD”, që prej themelimit të tij bazuar në VKM Nr. 650 datë 14.9.2011 “Për licensimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara “REALD”, është program nën kujdestarinë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (FSHM) dhe Departamentit të Stomatologjisë. FSHM kryen koordinimin midis departamenteve të tij për kryerjen e programit, si dhe marrëdhëniet me të tretët ku studentët kryejnë praktikën mësimore. Pjesë e punës koordinuese është përgatitja e ngarkesës mësimore, përcaktimi i titullarëve të lëndëve sipas kategorive, sipas kërkesave të rregullores institucionale. (Evidenca nr.4. Rregullore e KUR, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik .)
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda	Kolegji Universitar “REALD” me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione mësimore dhe klinike dentare për praktikën. Kolegji ka marrëveshje me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Albanian University Tiranë,

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*

*Pur*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universitetin e Salernos, Universitetin e Barit – Itali, për shkëmbim eksperience përmes stafit, përgatitjes së kurrikulave dhe programeve të studimit. <i>(Evidenca nr.27-31. Marrëveshje bashkëpunimi me IAL dhe lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me klinika dentare)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Për realizimin e programit të studimit, Kolegji Universitar “REALD” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me struktura stomatologjike për praktikat profesionale, ku bëjnë pjesë 13 klinika private stomatologjike. Gjithashtu, KUR ka marrëdhënie edhe me institucione shkencore, si Universiteti Salernitanës, Barit, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Albanian University. <i>(Evidenca nr.31. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me klinika dentare)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Stomatologjisë përgatit raport analitik mbi efikasitetin e bashkëpunimit me klinikat dentare në rrethin e Vlorës, ku shpjegohet se gjatë zhvillimit të praktikës mësimore, studentët mbikëqyren nga mjeku stomatolog i klinikës dhe një pedagog i Departamentit të Stomatologjisë i përcaktuar për ndjekjen e praktikave mësimore. <i>(Evidenca nr. 32. Raport analitik mbi efikasitetin e bashkëpunimit me klinikat dentare në rrethin e Vlorës)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar “REALD” ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore IAL vendase dhe të huaja, 13 klinika private në funksion të realizimit të programit të studimit MSc në Stomatologji, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.asca.al](http://www.asca.al)





Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i integruar i studimit cikli dytë në “Stomatologji”, është i organizuar në lëndë sipas kategorisë (A,B,C,D,E), lëndë dhe module, sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë”. Plani mësimor është i organizuar në 5 vite akademike, 10 semestra, 30 kredite çdo semestër, 300 kredite gjithë programi. 1 kredit ekuivalentohet me 25 orë mësimore.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Plani Mesimor i programit te integruar Msc. Stomatologji 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë</p>	<p>Programi i integruar i studimit cikli dytë në “Stomatologji”, përmes syllabuseve dhe strukturës mësimore dhe praktikës profesionale, synon formimin e shprehive të vecanta në fushën e stomatologjisë, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në fushën profesionale stomatologjike, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në stomatologji. Këto objektiva janë të përcaktuara edhe në “Rregulloren e programit të studimit MSC në Stomatologji “miratuar me Vendim Nr.39 datë 10.09.2020 të Senatit Akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 9. Rregullore e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>të specializuar studimi ose profesionale.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar (<i>Evidenca nr. 7. Plani Mesimor i programit të integruar Msc. Stomatologji 2021-2022</i>) konstatohet se në Planin Mësimor të programit të studimit është specifikuar qartë se realizimi i praktikës mësimore është lëndë e kategorisë D, vlerësohet me 14 kredite dhe realizohet në semestrin e dhjetë të studimeve. Detyrimet përmbyllëse, mikrotezë paraqesin detyrim të kategorisë E, vlerësohen me 15 kredite dhe kryhen në përfundim të semestrit të dhjetë të studimeve dhe pasi studenti ka plotësuar të gjitha detyrimet për shlyerjen e krediteve.</p> <p>(<i>Evidenca nr. 6. Programi mësimor i programit të integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Stomatologji"</i>)</p> <p>(<i>Evidenca nr. 7. Plani Mesimor i programit të integruar Msc. Stomatologji 2021-2022</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><b>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për</p>	<p><b>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. KU “Reald”, nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Referuar RVB, programi i studimit MSc në “Stomatologji” është i njëjtë me programe studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtësë, të ofruar nga Universiteti i Mjeksisë Tiranë, Albanian University, Universiteti Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë”, në masën 70%. Kjo lehtëson mobilitetin e studentëve.
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas Rregullores së programit të studimit, ky program është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve organizohet me 300 ECTS dhe kohëzgjatje normale 5 (pesë) vite akademike me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.  Plani mësimor i programit të studimit MSc në “Stomatologji” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit, dhe më tej çdo lëndë është kodifikuar sipas planit, psh Modul 1. Anatomia humane, Kodi ANT141. <i>(Evidenca nr.7. Plani mësimor i programit të integruar i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i>
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit MSc në “Stomatologji” është program i Kolegjit Universitar “REALD” pavarësisht përpjekjeve për program të integruar studimi të ciklit të dytë MSC në “Stomatologji dhe Proteza Dentare” në bashkëpunim me Universitetin e Foggias, por me Urdhërin Nr. 259 datë 19.07.2021 u kthye në MSC në Stomatologji ofruar nga vetëm Kolegji Universitar “REALD”/KUR/.





	<i>(Evidenca nr.37. Urdhër i MASR për riorganizimin e programit të integruar i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit MSc në Stomatologji është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi, Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë, si dhe Statutin dhe Rregulloren e brendshme.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Sipas dokumentave në sistemin e ASCAL, në 20/10/2017, me Vendimin nr. 93 të Bordit të Akreditimit, KU “Reald” është akredituar në nivel Institucional për pesë vite duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni. Kolegji ka përfunduar procesin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit periodik, dhe është në proces të vendimmarrjes nga Bordi i Akreditimit.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Stomatologjisë pranë Kolegjit Universitar “REALD” janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Njësia kryesore (FSHM) është e përbërë nga 4 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore,</li> <li>2. Departamenti i Farmacisë,</li> <li>3. <b>Departamenti i Stomatologjisë,</b></li> <li>4. Departamenti i Veterinarisë.</li> </ol> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



61 pedagogë, nga të cilët 48 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

(Evidenca nr. 85. Tabelat permbledhese per Anels-RVB per programin Bachelor ne Infermieri)

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekesore	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	1
Prof.Asoc	-	2
Dr/PhD	18	6
Msc	27	4
<b>Gjithsej</b>	<b>48</b>	<b>13</b>

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MSc në “Stomatologji”, Departamenti i Stomatologjisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	1	-	-	-
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-
Dr./PhD.	2	5	3	4	5	5
Msc.	5	1	5	1	8	1
<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>6</b>

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave

Njësia bazë që organizon programin e studimit MSC në “Stomatologji”, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, bazuar në shpërndarjen e orëve mësimore në stafin pedagogjik. Njësia bazë me Urdhër nr. 2 datë 20.01.2023 “ Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinike, në programin e integruar të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabhu*

*Pa*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



mësimore, laboratorike e klinike, etj.	studimit “Master i shkencave” në “Stomatologji” të Përgjegjës të Departamentit, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar Msc. K. D. për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Me Vendim Nr. 1, datë 02.11.2021 të Rektorit, Për emërimin e Koordinatorit të programit MSC në “Stomatologji” përcaktohet stafi i brendshëm K. M. koordinatorë e programit. Ky vendim ka të përcaktuara qartë edhe detyrat e koordinatorit të programit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij (Evidenca nr. 34. Vendim Nr. 1, datë 02.11.2021 të Rektorit, Për emërimin e Koordinatorit të programit MSC në “Stomatologji”)</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjeksore, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Përgjegjësi Departamentit ngarkohet me detyrat e koordinatorit të programit të studimit. Këto detyra përshkruhen në <i>Nenin 8: Përgjegjësi i Departamentit</i></p> <p>Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë akademik për departamentin. Detyrat dhe kompetencat e tij janë :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejton punën për hartimin e planeve mësimore dhe programeve të lëndëve që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre;</li> <li>2. Ndjek dhe kontrollon aktivitetin shkencor në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktiviteti shkencor dhe akademik të anëtarëve të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij;</li> </ol> <p>(Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjeksore, neni 8)</p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Mjeksore dhe Departamenti i Stomatologjisë pranë Kolegjit Universitar “REALD”, përgjegjës për programin e studimit MSc në Stomatologji, janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në RVB si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit (Plani Mësimor i Programit të Studimit, udhëzime për studentët, etj), dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit “Msc në Stomatologji” në KU “Reald” disponohen nga Fakulteti i Shkencave Mjeksores (njësia kryesore) dhe Departamenti i Stomatologjisë (njësia bazë) si edhe elementet kryesore të tyre janë publike dhe të mundshme për t’u aksesuar lirisht.</p> <p><i>(Evidenca nr. 9. Rregullore e programit te integruar Master i shkencave në Stomatologji)</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 15. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve)</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 17. Rregullore e diplomimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit MSC në Stomatologji, është organizuar sipas kërkesave të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1, shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018. Programet e studimit janë të organizuar në :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Lëndë bazë A me 60 kredite= 20 %</li> <li>➤ Lëndë Karakterizuese B me 165 kredite = 55% (A+B= 225 kredite&gt;70%)</li> <li>➤ Lëndë ndërdisciplinore integruese C me 36 kredite = 12%</li> <li>➤ Lëndë plotësuese D me 24 kredite = 8 %</li> <li>➤ Lëndë përmbyllëse E me 15 kredite =15 %</li> </ul> <p>Bazuar në planin mësimor, çdo kredit korrespondon me 25 orë mësimore, ku përfshihen orë në auditor dhe orë jashtë auditorit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 7. Plani mësimor i programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MSC në Stomatologji është organizuar bazuar në “Rregulloren e programit të integruar e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor në Stomatologji” miratuar me Vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, ku në <i>Kreun IV</i>, Pranimi i studentëve, Gjithashtu, kriteret e pranimit janë përshkruar edhe në Vendimin Nr. 1 datë 08.01.2021 të Senatit Akademik, “Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023”.</p> <p><i>(Evidenca nr. 9. Rregullore e programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, dhe programet lëndore të tij (syllabuset) janë të përgatitura bazuar në kërkesat e VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL “ shtojca 2.</p> <p>Në syllabuse janë të përshkruara qartë praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 8. Syllabuset)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e programit “Master i Shkencave “ në “Stomatologji” i është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve në masën mbi 20% së fundmi me Urdhër nr. 259 datë 19.07. 2021 “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të integruar i ciklit të dytë “Master i Shkencave “ në “ Stomatologji dhe proteza dentare”, në program të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave “ në “Stomatologji, në Kolegjin Universitar REALD”. Këto ndryshime janë bërë me miratim të Senatit Akademik Nr.39, datë 10.09.2020, çfarë tregon për një proces përmirësimi të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 36. Shkresa drejtuar MASR për riorganizimin e programit të të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave “ në “Stomatologji, në Kolegjin Universitar REALD”)</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 37. Urdhër i MASR nr. 259, datë 19.07.2021, “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të integruar i ciklit të dytë “Master i Shkencave “ në “ Stomatologji dhe proteza dentare”, në program të integruar të ciklit të dytë</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<i>“Master i Shkencave “ në “Stomatologji, në Kolegjin Universitar REALD”)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit Msc në Stomatologji është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Programi i studimit MSC në Stomatologji, është organizuar sipas kërkesave të të VKM Nr.41, datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1, shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi mësimor në MSC në Stomatologji është i përbërë nga leksione, seminare, laboratorë dhe praktika. Shpërndarja dhe emërtimi i lëndëve, sipas kategorive, në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe formuese, raporti teori/praktikë, jo vetëm japin mundësi në thellimin e njohurive dhe aftësive praktike për punësim, ose studime të mëtejshme. Një pjesë të rëndësishme zënë veprimtaritë praktike në laboratorët mësimorë dhe klinikat stomatologjike. Kryerja e praktikave mësimore pranë klinikave stomatologjike private mundëson edhe punësimin e tyre në këto klinika në përfundim të studimeve. <i>(Evidenca nr. 7. Plani mësimor i programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Programi “Master i Shkencave “ në “Stomatologji” është i organizuar në 5 vite, 10 semestra, 300 kredite.  Në vitin e parë të studimeve hidhen bazat e formimit të përgjithshëm dhe shëndetësor: Kimi, biologji, bazat e anatomisë I, fizikë.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p>rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Në vitin e II, III, IV dhe V, studenti ndjek lëndët e formimit klinik dhe profesional stomatologjik: kirurgji stomatologjike, terapi stomatologjike, protetike stomatologjike, patologji e përgjithshme, farmakologji, bazat e anatomisë II, biokimi mjeksore, mjeksi ligjore, ortodonci, higjene dhe organizimi shëndetësor, paradontologji dhe patologji speciale, pedeodonti dhe psikologji mjeksore, lëndë me zgjedhje, teknika e higjenës profesionale orale.</p> <p>Studentët kryejnë përgatitje profesionale gjatë 5 viteve në laboratorë dhe klinika dentare private, dhe praktikë profesionale në fund të vitit të pestë që ka 14 kredite. Shpërndarja e krediteve është bërë në varësi të kategorisë së lëndës, orëve mësimore dhe rëndësisë së saj, psh. Kirurgji stomatologjike ka 32 kredite, kryhet në vitin e II, III, IV dhe V, ndërsa kimia (organizke dhe inorganike) ka 8 kredite.</p> <p><i>(Evidenca nr. 7. Plani mësimor i programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi “Master i Shkencave “ në “Stomatologji” është ngritur fillimisht nën kujdesin dhe modelin e stomatologjisë në IAL publike, më vonë është përditësuar me programet e Universitetit “Aldo Moro” në Bari, Itali. Struktura e lëndëve përbëjnë drejtimet kryesore të formimit profesional si stomatolog: klinike dhe puna me pacientin. Laboratorët profesionlë në cdo lëndë apo modul profesional është pjesë e programit mësimor. Raporti teori praktikë është mbi 50% në favor të praktikave profesionale.</p> <p>P.sh. Protetikë stomatologjike I +II kanë 106 orë mësimore dhe 110 orë seminare dhe praktika laboratorike.</p> <p>Në planin mësimor, nga 300 kredite në total, praktika profesionale si lëndë e veçantë përmban 14 kredite (ECTS), duke shtuar informacionin që cdo lëndë ka orë laboratorike klinike në laboratorin e stomatologjisë, apo në klinikën stomatologjike universitare, çfarë përmbush pritshmëritë për formimin teorik dhe praktik të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 7. Plani mësimor i programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji”)</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura e programit është në funksion të objektivave të përcaktuara në rregulloren e programit “Master i Shkencave” në “Stomatologji” të Kolegjit Universitar “REALD”. Veprimtaritë formuese të programit mësimor janë ndarë në 50% leksione teorike dhe 50% formim praktik , të përbërë prej laboratorëve , seminareve, praktikave, projekte kursi. Struktura e programit mësimor me lëndë, veprimtari mësimore dhe kredite e ngjashme me programe të tjera Msc në Stomatologji në fakultete të tjera, bën të mundur transferimin e studentëve, mobilitetin, kalimin e provimit të licencës dhe punësim.</p> <p><i>(Evidenca nr.9 . Rregullore e programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji” miratuar me Vendim Senati Nr. 39, datë 10.09.2020)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i syllabuseve sipas dokumentave është bërë në mënyrë periodike, edhe si pasojë e organizimeve dhe riorganizimeve të programeve në bashkëpunim me institucione mësimore vendase dhe të huaja, si Universiteti i Foggias, Barit. Kjo ka bërë që syllabuset të jenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Rishikimi në masën mbi 20% ka ndodhur në vitin 2020 me Vendim nr. 10 datë 1.09.2020 të Senatit Akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr.36 . Shkresa drejtuar MASR për riorganizimin e programi të integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji” bazuar në Vendim Senati Nr. 39, datë 10.09.2020)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Master i Shkencave “ në “Stomatologji” ofruar nga Kolegji, bazuar në objektivat e programit të studimit, synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e stomatologjisë: të përgatisë stomatologë me formim të spikatur teoriko – praktik, te afte qe te përballojnë kërkesat gjithmonë ne rritje te sistemit tone mjekësor ne përgjithësi dhe atij stomatologjik ne veçanti. Te diplomuarit duhet jene te përgatitur ne ushtrimin e profesionit në stomatologji, ata duhet te kenë aftësinë për t’i shërbyer shoqërisë me etike dhe përkujdesje profesionale.</p> <p>Lëndët pjesë e programit mbulojnë spektrin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Bazat e Anatomisë, Fiziologjisë, Biokimisë dhe shume aspekteve te tjera normale te organizmit;</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Aspektet fiziopatologjike te organizmit si dhe njohuri mbi disa nga sëmundjet kryesore te tij;</li> <li>▶ Mbi grupet e ndryshme te medikamenteve, origjinën e tyre, mënyrat e përthithjes dhe eliminimit nga organizmi.</li> <li>▶ Njohuri te përgjithshme për sëmundjet e brendshme dhe kirurgjikale;</li> <li>▶ Në fushën e përgatitjes profesionale do të marrin njohuri për dentistrinë, protetikat , kirugji orale dhe anestezinë, etj;</li> </ul> <p><i>(Evidenca nr.6 . Program mësimor i integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji” bazuar në)</i></p>								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Struktura mësimore e programit të studimit Msc në Stomatologji mundëson pajisjen e studentëve me njohuritë e duhura për të vazhduar studime të mëtejshme në ciklin e tretë. Gjithashtu, kompetencat profesionale të fituara gjatë praktikave profesionale pranë klinikave stomatologjike private dhe laboratorëve klinikë, bëjnë të mundur punësimin e studentëve të diplomuar pranë KUR bazuar në nevojat e tregut dhe shërbimeve shëndetësore.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Msc në Stomatologji është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit 7 sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe	Kolegji Universitar “REALD” ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në vende të BE, (në Itali -Salerno, Bari; Spanjë - UCAM), me objektiv përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe përmbajtjes së programit

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>mësimor. Pjesë e marrëveshjes është edhe konsultimi për përmirësimin e përmbajtjes së programeve dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës. Rezultat i këtyre propozimeve ka qenë edhe organizimi dhe riorganizimi i programit të “Master Shkencor” në “Stomatologji” në vitin 2020 me Vendim nr. 10 datë 1.09.2020 të Senatit Akademik. (Evidenca nr.63 . Lista e IAL me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi KUR; Evidenca nr.30: Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Salernos)</p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka në strukturën e tij Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila ndjek ecurinë e punësimit të studentëve të diplomuar në KUR, por edhe mbedh mendime për përmirësimin e programit. Studentët gjatë takimit deklaruan që kanë paraqitur pranë departamentit të stomatologjisë kërkesën për më shumë praktika profesionale, çfarë është një input pozitiv. (Evidenca nr. 14. Rregullore e Këshillimit të Karrierës)</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Stomatologjisë në KUR si njësia përgjegjëse e programit Msc në Stomatologji, në bashkëpunim me institucionet mësimore (Universiteti Mjekësor i Tiranës, “Aldo Moro” Bari, Salernos, UCAM), klinikat dentare private dhe publike si dhe Urdhëri i Stomatologut, diskuton trendin në fushën e stomatologjisë dhe punësimit të stomatologëve, dhe si të përmirësojnë programet e studimit.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Universitar “REALD” nxit përfshirjen e studentëve dhe IAL me të cilët ka marrëveshje, si dhe klinika private stomatologjike, në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi mësimor “Master i Shkencave në “Stomatologji” ka të përcaktuar qartë në pikën 8 të tij objektivat e programit të studimit. Këto objektiva janë në përputhje me objektivat e “Strategjia e zhvillimit 2021-2026” të “KUR miratuar me Vendim Nr. 36, datë 01.06.2020 të Senatit Akademik, dhe “Strategjia dhe plani afatmesëm i kërkimit shkencor” për periudhën 2019-2024 i KUR, miratuar me Vendim Nr. 28, datë 16.12.2019 të Senatit Akademik. KUR ka ngritur Qendrën Kërkimore si strukturë që mbështet kërkimin shkencor me “knoë hoë” dhe financiarisht. <i>(Evidenca nr.6 . Program mësimor i integruar ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji;</i> <i>Evidenca nr. 68: Vendim Nr. 36, datë 01.06.2020 të Senatit Akademik për “Strategjia e zhvillimit 2021-2026” të “KUR )</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjeksore, <i>neni 7 dhe neni 8, Zv. Dekani dhe Shefi i departamentit janë përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë mësimore duke miratuar syllabuset, programet dhe orarin mësimor, si dhe veprimtarinë mësimdhënëse. Fakulteti dhe departamenti janë përgjegjës edhe për përgatitjen dhe miratimin e planit të aktiviteteve shkencore në çdo fillim viti, i cili më pas miratohet nga Senati Akademik.</i> <i>(Evidenca nr.5 . Rregullore e Fakultetit të shkencave Mjeksore)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi mësimor dhe plani vjetor i aktiviteteve shkencore, mundëson përfshirjen e studentëve në aktivitete kërkimore shkencore. Edhe përgatitja për tezën e diplomës, është një proces që i mundëson studentëve formimin e elementeve të përgatitjes së një materiali shkencor.
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Kolegji Universitar “REALD” miraton çdo vit një fond për mbështetjen e kërkimit shkencor përmes Senatit Akademik, si institucioni që miraton buxhetin institucional. Në vitin 2021, Bordi i Administrimit përmes Vendimit Nr. 5 datë 20.10.2021 “Miratim fondi për kërkimin shkencor për vitin akademik 2021-2022, në Kolegjin Universitar REALD”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<i>(Evidenca nr.43 . Vendimit Nr. 5 i Bordit të Administrimit datë 20.10.2021 “Miratim fondi për kërkimin shkencor për vitin akademik 2021-2022, në Kolegjin Universitar REALD”.)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi mësimor “Master i Shkencave në “Stomatologji” ka të përcaktuar qartë në pikën 8 të tij objektivat e programit të studimit. Këto objektiva janë në përputhje me objektivat e “Strategji zhvillimi” të “KUR miratuar me Vendim Nr. 6, datë 07.06.2020 të Senatit Akademik, dhe “Strategjia dhe plani afatmesëm i kërkimit shkencor” për periudhën 2019-2024 i KUR, miratuar me Vendim Nr. 28, datë 16.12.2019 të Senatit Akademik. KUR ka ngritur edhe Qendrën Kërkimore, si struktur që mbështet kërkimin shkencor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Departamenti i Stomatologjisë mbështet projektet kërkimore shkencore përmes planit kërkimor shkencor vjetor, që miratohet në Senatin Akademik të KUR. Gjithashtu, në programin mësimor përfshihen lëndë që japin bazat e kërkimit shkencor (statistika, epidemiologjia) si dhe siguron mbështetje për studentët në përgatitjen e tezës së diplomës, për të realizuar objektivat e programit të studimit në kërkim shkencor.</p> <p>Departamenti i Stomatologjisë në KUR si njësi përgjegjëse e programit Msc në Stomatologji, në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka me institucionet kërkimore shkencore si (Universiteti Mjeksor i Tiranës, “Aldo Moro” Bari, Salernos, UCAM), përfshin edhe projekte kërkimore shkencore, që ndihmojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca nr.63 . Lista e IAL me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi KUR; Evidenca nr.30: Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Salernos)</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prutina*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Bazuar në “Strategjia dhe plani i punës afatmesëm për Kërkimin Shkencor 2019-2024” miratuar me Vendim Senatit Akademik nr.28 datë 16.12.2019, Departamenti i Stomatologjisë angazhohet në zbatimin e planit vjetor të kërkimit shkencor. Për këtë qëllim, Departamenti angazhon personelin akademik dhe studentët.</p> <p><i>(Evidenca nr.39 . Vendim Senatit Akademik nr.28 datë 16.12.2019 për miratimin e “Strategjia dhe plani i punës afatmesëm për Kërkimin Shkencor 2019-2024”, Evidenca nr. 25 “Plan pune i kërkimit shkencor për vitin akademik 2021-2022, miratuar me Vendim nr.11 datë 04.11.2021 të Senatit Akademik)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” dhe Departamenti i Stomatologjisë, organizojnë aktivitete që ndihmojnë stafin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave të programit mësimor. KUR ka organizuar Konferencën Ndërkombëtare “Shkenca dhe Inovacioni 2021” në bashkëpunim me European Institute for Multidisciplinary Research Rumania, Romanian Academy of Scientists, si dhe Konferencën “ Interferenca Interdisiplinari in Medicina Odontoiatrica”.</p> <p><i>(Evidenca nr. 25 “Plan pune i kërkimit shkencor për vitin akademik 2021-2022, miratuar me Vendim nr.11 datë 04.11.2021 të Senatit Akademik)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Një nga objektivat e programit MSc në Stomatologji është formimi i profesionistëve Stomatologë me formim teoriko-praktik që të jenë të aftë të përballojnë kërkesat për punësim në Shqipëri dhe tregun ndërkombëtar. Programi synon që të japë aftësi profesionale në ushtrimin e profesionit të stomatologut. Edhe struktura mësimore dhe bashkëpunimi me IAL Europiane i përgatit për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>(Evidenca nr.63 . Lista e IAL me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi KUR; Evidenca nr.30: Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Salernos)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për</p>	<p>Departamenti i Stomatologjisë përditësohet me rekomandimet dhe kërkesat ligjore të nxjerra nga urdhëri stomatologut apo shoqatat profesionale, me qëllim përmirësimin e programit. Gjithashtu, Departamenti cdo fund viti shkollor, kryen takime me studentët në prag diplomimi me qëllim informimi për kërkesat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	ligjore për profesionet e rregulluara për marrjen e licencës së stomatologut.			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian ( <i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Programi mësimor i MSc në Stomatologji është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 të “Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor në IAL”, dhe Direktivës 2005/36/EU. Në cdo lëndë, përvec leksioneve dhe seminareve, ka numër të konsiderueshëm orë laboratorike me qëllim që studentët të aftësohen praktikisht. Programi ka edhe 14 kredite praktikë profesionale, që zhvillohet në klinika private, çfarë bën të mundur dhënien e kompetencave profesionale. Numri i studentëve të regjistruar në program është i kufizuar, çfarë mundëson zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave në grupe të vogla, çfarë mundëson dhënien dhe kontrollin maksimal të aftësive praktike. ( <i>Evidenca nr.7: Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave “ në “Stomatologji”</i> )			
<b>Konkluzione</b>	Në programin mësimor përfshihen lëndë që japin bazat e kërkimit shkencor (statistika, epidemiologjia) si dhe siguron mbështetje për studentët në përgatitjen e tezës së diplomës, për të realizuar objektivat e programit të studimit në kërim shkencor. KUR ka bashkëpunim me institucione mësimore dhe kërkimore shkencore, çfarë bën të mundur përgatitjen e duhur të profesionistëve për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Departamenti i Stomatologjisë mbështet projektet kërkimore shkencore përmes planit kërkimor shkencor vjetor, që miratohet në Senatin Akademik të KUR.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Programi i studimit i Integruar i Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji” organizuar nga Kolegji Universitar “REALD” është bazuar në planin e programit mësimor të miratuar me Vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, dhe miratuar me Urdhër Nr. 259, datë 19.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Në këtë program mësimor janë përkrahur të gjitha format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, si janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura.</p> <p><i>(Evidenca nr. 7. Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave “ në “Stomatologji”)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	<p>Bazuar në programin mësimor të miratuar me Vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, dhe miratuar me Urdhër Nr. 259 datë 19.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, personeli akademik, ofron metoda të ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies. Përveç këtyre metodave, personeli akademik në bashkëpunim me Departamentin përkatës ju kanë ofruar studentëve leksione të hapura dhe konferenca shkencore, duke ju dhënë studentëve mundësi alternative të mësimnxënies. Po kështu edhe studentët u shprehën pozitivisht për procesin mësimor duke konfirmuar ekzistencën e formave dhe mënyrave të ndryshme alternative të mësimit, sidomos formave të reja të mundësuar edhe me ndihmën e teknologjisë dhe aksesit në bibliotekat mësimore online.</p> <p><i>(Evidenca nr. 6. Programi mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave “ në “Stomatologji”)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në	Kolegji Universitar “REALD” mbështet personelin jo vetëm me infrastrukturën përkatëse për ofrimin e metodave klasike të

Adresa: “Ruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabur*

*[Signature]*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>mësimdhënies (leksione, seminare, laboratorë, praktika), por edhe me metoda inovative të mësimdhënies/mësimnxënies në distancë, si: Google Classroom për studentët dhe stafin akademik, programin OBS për regjistrimin Video dhe Audio , të leksioneve dhe seminareve, që ju shpërndahet studentëve dhe personelit akademik. Në planin buxhetor të përvitshëm, KUR parashikon fonde për kërkimin shkencor dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidenca nr. 43.Vendim nr. 5 datë 20.10.2021për miratim fondi për kërkim shkencor për vitin akademik 2021-2022 në KUR)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Kopetenca profesionale dhe pedagogjike e stafit akademik të punësuar pranë KUR sigurohet fillimisht te kriteret në punësim, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, specializimin përkatës dhe eksperiencën profesionale. Stafi pedagogjik ka Curriculum Vitae të përshtatshme për të qenë kopetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, gjithashtu, stafi është i aftë të përdorë metoda të ndryshme të mësimdhënies, si dhe nxisë studentët drejt diskutimeve krijuese dhe punëve laboratorike me qëllim rritjen e autonomisë së marrjes së vendimeve profesionale nga ana e tij. Diskutimi i rasteve klinike është një nga metodat që nxit të mësuarin kritik dhe rrit aftësinë e vendimmarrjes.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në KUR funksionon Këshilli Studentor, i cili ka përfaqësuesit e tij në Senat, por gjithashtu është një aktor i rëndësishëm për ngritjen e zërit të studentëve në lidhje me kërkesat e tyre. KUR dhe Këshilli Studentor bashkëpunojnë dhe në mënyrë periodike përmes pyetsorëve, vlerësojnë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies, si dhe ti reflektojnë ato në përmirësimin e metodologjisë. Rezultatet e anketimit janë paraqitur në Raportin vjetor 2021 -2022 të NJSBC, Nr. 272 Prot.</p> <p><i>(Evidenca nr. 23.Raport vjetor për NJSBC 2020-2021)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel</p>	<p>KUR ka ngritur me Vendim Nr. 11 datë 15.10.2021 të Senatit Akdemik “Strukturën e sigurimit të cilësisë dhe këshillimit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p>institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>karrierës” i cili është njësi që koordinon punën midis njësite kryesore dhe ature bazë, për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. NJSBC përmes metodave të ndryshme, duke përfshirë edhe anketimin e studentëve, bën të mundur që procesi i përmirësimit të përfshij edhe mendimn e palëve per të cilët ekziston KUR, që janë studentët. Me qëllim eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie, KUR ka ngritur edhe Qendrën Kërkimore Shkencore, e cila përgatit plane vjetore për aktivitetin e saj (plani vjetor 2021-2022), dhe mbështet me buxhetin përkatës nga institucioni.</p> <p><i>(Evidenca nr. 12. Rregullore e NJSBC miratuar me Vendim nr.19 datë 01.08.2017 të Senatit Akademik)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Universitar “REALD” garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.Ky proces mbështetet dhe bazohet në rregulloren e NJSBC.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>KUR ka një bazë rregullatore të mirëorganizuar në lidhje me mënyrat dhe testimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Rregullore e Kolegjit Universitar “REALD”, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</li> <li>❖ Rregullore e FSHMT miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Rregullore e zhvillimit të provimeve, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</li> <li>❖ Rregullore e diplomimit të studentëve miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</li> </ul> <p>Këto vendime janë publike në websitin e Kolegjit dhe ju bëhen të ditur studentëve në fillim e cdo viti akademik.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në takimin e organizuar me studentët e programit Msc në Stomatologji të KUR, theksojmë që në fillimin e cdo lënde apo moduli, ata informohen nga pedagogu i lëndës, për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Zakonisht ora e parë e çdo lënde rezervohej për prezantimin e detajuar nga ana e titullarit të lëndës të përmbajtjes së lëndës / modulit dhe detyrimeve të studentëve. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit student / pedagog në klasat e menaxhuara në platformën e menaxhimit të mësimi dhe nëpërmjet emailit institucional me të cilin ishte i pajisur çdo student.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në rregulloret si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Rregullore e Kolegjit Universitar “REALD”, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik,</li> <li>❖ Rregullore e FSHMT miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik</li> <li>❖ Rregullore e zhvillimit të provimeve, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik</li> <li>❖ Rregullore e diplomimit të studentëve miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</li> </ul> <p>në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Stomatologji” përdoren metoda të ndryshme të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Metodatat e përdorura janë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- provim me shkrim (pyetje shtjelluese ose me opsione);</li> <li>- pyetje me goje;</li> <li>- detyra kursi;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstrim teknikash;</li> <li>- vlerësim me shkrim i udhëheqësit të praktikave;</li> <li>- provim me shkrim formues ose temë diplome;</li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<i>KUR ka të hartuar "Rregulloren e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave "në "Stomatologji", miratuar me Vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, Rregullore e FSHMT miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Rregullore e zhvillimit të provimeve, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Rregullore e diplomimit të studentëve miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik; ku përcaktohen metodat e ndryshme të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th><b>Përmbushet pjesërisht</b></th> <th><b>Përmbushet kryesisht</b></th> <th><b>Përmbushet plotësisht</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve dhe Rregulloren e Përgjithshme të KUR, është parashikuar testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Në syllabusin e lëndës vlerësimi i vazhdueshëm përbën 30% të pikëve në vlerësimin përfundimtar të studentit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 8. Syllabuset)</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>KUR ka në zbatim mënyra të ndryshme për të shmangur forma të ndryshme abuzimi dhe për të rritur transparencën. Institucioni ka sistem elektronik testimi dhe vlerësimi për testin e hyrjes së studentëve në programin e studimit. Gjithashtu, gjatë pandemisë, institucioni ka përdorur testimin on-line. Ku testi ju dërgohej në formë linku, dhe studenti e plotësonte nën mbikqyrje të komisionit të provimit on-line. Për testimin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabh...*

*[Signature]*




	lëndëve, provimet kryhen në salla të mbikqyrura nga kamera, që redukton mundësinë e kopjimit, dhe rezultatet jepen brenda 3 ditëve nga kryerja e provimit.
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet nga pedagogu lektor, nën mbikqyrjen e titullarit të lëndës, dhe teza e përgatitur prej tij firmoset nga Drejtuesi i Departamentit. Provimi bëhet me gojë përballë një komisioni prej 3 vetash, ose me shkrim nga një komision prej 2 vetash. Përmbajtja e tezës bazohet në syllabusin e lëndës të dhënë gjatë viti akademik, dhe përban gjithë elementët informues të kërkuara nga baza ligjore në fuqi.
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët jua mundësojnë studentëve që të marrin feedback për performancën e tyre gjatë provimit. Në provimet me gojë, këto këshilla jepen direkt. Në provimet me shkrim, këshillat jepen ndaj studentëve të cilët dëshirojnë të shikojnë tezën dhe vlerësimin që kanë marrë.
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësia përgjegjëse dhe KUR kanë përgatitur Rregullore për përgatitjen e temës së diplomës, si dhe Rregulloren e zhvillimit të provimeve, të cilat shmangin mundësinë e plagjiaturës dhe të kopjimit. Edhe në syllabuset e lëndëve shprehet qartë kërkesa për integritet akademik dhe shmangie të plagjiaturës. Provimet kryhen në salla me kamera me qëllim shmangien e kopjimit nga studentët. <i>(Evidenca nr. 15. Rregullore për zhvillimin e provimeve, Evidenca nr.16. Rregullore për punimin e diplomës)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e testimeve apo vlerësimit të kopetencave profesionale bëhen bazuar në meritën e studentit, dhe sipas Rregullores së Përgjithshme të Kolegjit, <i>Neni 58</i> , rezultatet e provimeve jepen brenda 3 ditëve nga kryerja e provimit. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, dhe printohet procesverbali, i cili firmoset nga lektori dhe depozitohet në sekretari dhe departament. <i>(Evidenca nr. 4. Rregullore "Rregullore e përgjithshme e IAL KUR)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u	Sipas Rregullores së Përgjithshme të Kolegjit, <i>Neni 58</i> , institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*





Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit. 1 ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. Në rast paqartësisht, studenti ka të drejtë të shikojë provimin në prezencën e pedagogut. Për sqarime të mëtejshme student i drejtohet me shkrim Shefit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore "Rregullore e përgjithshme e IAL KUR)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Institucioni ka të sanksionuar në kuadrin rregullator të tij: Rregullore e përgjithshme e KUR, Rregullore e FSHM, Rregullore e zhvillimit të provimeve, Rregullore e Diplomimit; që cdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Sipas kuadrit rregullator:</p> <p>1 ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. Në rast paqartësisht, studenti ka të drejtë të shikojë provimin në prezencën e pedagogut. Për sqarime të mëtejshme student i drejtohet me shkrim Shefit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse. Në pamundësi të zgjidhjes së ankesës, Shefi Departamentit vë në dijeni Dekanin, i cili brenda 48 orësh nga marrja dijeni e ankesës, ngre një komision ad hoc prej 3 anëtarësh, i cili verifikon pretendimet e studentit duke vlerësuar tezën e provimit me shkrim. Në rast se provimi është dhënë me gojë, studenti e përsërit provimin në prani të komisionit ad hoc, duke tërhequr një tezë të dytë. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të studentit. Ndryshimi i notës pasqyrohet në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni ad hoc, dhe i bashkangjitet procesverbalit të mëparshëm.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka kuadër rregullator që siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet bazuar në programin e parashikuar në syllabusin e lëndës, dhe kryhet bazuar në rregulloren e programit të studimit. KUR ka në vendosur sistemin e kamerave mbikqyrëse në sallat ku kryhen provimet. Kjo shmang mundësinë e abuzimit dhe të kopjimit. Tezat kontrollohen nga Shefi Departamentit</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<i>dhe janë përgjegjësi e Pedagogut të lëndës, Përgjigjet jepen brenda 3 ditëve.</i>			
	<i><u>Sugjerohet që institucioni të mundësojë sekretimin e provimeve me qëllim kryerjen e korrigjimeve "blind", duke rritur vlerësimin bazuar në meritë.</u></i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave në Stomatologji organizuar nga Kolegji Universitar "REALD" është bazuar në programin mësimor të riorganizuar miratuar me Vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, dhe me Urdhër Nr. 259 datë 19.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Në këtë program mësimor janë përshkruar të gjitha format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, që garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi mësimor i miratuar me Vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, dhe me Urdhër Nr. 259 datë 19.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, përmes lëndëve: statistikë, informatikë, mjekësi ligjore, higjenë dhe organizim shëndetësor, shëndet publik. <i>(Evidenca nr. 7. Plani Mesimor i programit te integruar Msc. Stomatologji 2021-2022)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Çdo titullar lënde ka përcaktuar në syllabusin e lëndës kompetencat dhe aftësitë që do të fitojë në përfundim të lëndës. Pedagogu i lëndës, gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, praktikave mësimore, orienton studentët për çështjet më të rëndësishme, si dhe detyrimet përmbyllëse që ai ka kundrejt plotësimit të programit. Detyrimet e studentit janë: pjesëmarrja

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabur*

*[Signature]*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	në lekcione, seminare, praktika, kryerja e detyrave të kursit, provimeve. Plotësimi i detyrimeve, bën të mundur që studenti të fitojë kompetencat dhe aftësitë përkatëse në përfundim të lëndës. <i>(Evidenca nr. 8. Syllabuset e lëndëve MSc në Stomatologji)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit Master Shkencor në Stomatologji ka si qëllim që të formojë profesionistë të fushës stomatologjisë, me kompetenca profesionale. Plani mësimor, ku përveç leksioneve dhe seminareve përfshihen edhe praktika mësimore e profesionale, praktika laboratorike, është i hartuar për të formuar profesionistë të aftë për të ofruar shërbim stomatologjik në mënyrë të pavarur. Për këtë qëllim, në planin mësimor është parashikuar praktika profesionale në klinika stomatologjike private prej 14 kredite. Por, praktikat janë të paraprirë nga leksione të dhëna nga specialistët përkatës të lëndës, bazuar në kompetencat profesionale të tyre, si dhe të shoqëruara me raste klinike, dhe zgjidhjen e tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Çdo fillim viti akademik, Qendra Kërkimore Shkencore përgatit planin vjetor të aktiviteteve shkencore, i cili miratohet nga Senati Akademik, dhe përgatitet në bashkëpunim me personelin akademik efektiv dhe me kontratë, ku përfshihen leksione të hapura, prezantimi i studimeve shkencore dhe njohja me të rejat më të fundit të shkencës.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Kolegji Universitar "REALD" përmes institucioneve të tij, si Senati Akademik dhe Bordi Administrimit, aprovon buxhet vjetor në mbështetje të kërkimit shkencor dhe ideve novatore. <i>(Evidenca nr. 43. Vendim I BA për miratim fondi për Kërkim Shkencor për vitin akademik 2021-2022)</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar REALD ka strukturë të posaçme në nivel institucional, që promovon rritjen e vetëdijes për përmirësimin</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prusha*

*[Signature]*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<i>e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit, si NJSBC dhe Qendra Kërkimore Shkencore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Kolegji Universitar “REALD” ka miratuar me Vendim Senati Nr.39 datë 10.09.2020 “Rregulloren e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave “ në “Stomatologji”, ku në <i>Kreu II, Organizaimi dhe drejtimi i programit të studimit, Neni 14</i> , “Provimi përfundimtar”, përcaktohet mbrojtja e diplomës sipas krediteve të përcaktuara në planin mësimor. Sipas planit mësimor diploma mbrohet me mikrotezë dhe ka 15 kredite. Departamenti ka përgatitur një udhëzues për hartimin e punimit të temës së diplomës. <i>(Evidenca nr. 9. Rregulloren e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave “ në “Stomatologji”)</i> <i>(Evidenca nr. 16. Udhëzuesi për punimin e temës së diplomës)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	KUR ka miratuar me Vendim Senati Nr.39 datë 10.09.2020 “Rregulloren e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave “ në “Stomatologji”, dhe udhëzuesit për hartimin e punimit të temës së diplomës, përcakton qartë procedura e përzgjedhjes së temës, struktura, përmbajtja, dorëzimi dhe mbrojtja e temës. Temat e Diplomës duhet të propozohen nga të gjithë mësimdhënësit. Çdo mësimdhënës duhet të propozoj deri në tetë tema për punimin e diplomës. Shefat e departamenteve duhet të paraqesin propozimin e Temave të Diplomës nga stafi akademik i katedrës përkatëse në fillim të çdo viti shkollor dhe sipas kërkesës së koordinatorit të programit edhe në periudha të tjera. Studentët nga programet e studimeve (dhe bachelor, të integruara dhe master) fillojnë procedurat për identifikimin e temës dhe mentorit potencial në vitin e fundit të studimeve.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




	<p>Kushti për përzgjedhjen e temës së diplomës është minus 3 provime nga viti i fundit i studimeve.</p> <p>Kohëzgjatja e përfundimit të temës së diplomës duhet të jetë jo më shumë se 3 muaj nga data e zyrtarizimit të temës.</p> <p><i>(Evidenca nr.16.Udhëzues për punimin e temës së diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Udhëzuesi për hartimin e punimit të temës së diplomës, përcakton qartë procedura e mbrojtja së temës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pas pëlqimit nga mentori për gatishmërinë e kandidatit, mbrojtja e temës bëhet brenda një javë pas përfundimit të procedurave përkatëse;</li> <li>• Komisioni vlerësues përbëhet nga tre anëtar, një prej tyre është mentori i kandidatit;</li> </ul> <p><i>(Evidenca nr.16.Udhëzues për punimin e temës së diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëzuesi për hartimin e punimit të temës së diplomës, përcakton qartë rolin e mentorit në përcaktimin e temës, përgatitjen e temës, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, shkrimin e punimit, strukturën e temës. Mentori i studentit në fund jep pëlqimin nëse tema është në përputhje me kriteret e vendosura në udhëzuesin e hartimit dhe punimit të diplomës. Tema e diplomës duhet të jetë e përgatitur brenda 3 muajve nga data e dhënies së temës së diplomës.</p> <p><i>(Evidenca nr.16.Udhëzues për punimin e temës së diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti dhe Udhëheqësi i temës, bazuar në “Rregulloren e studimit në Master i Shkencave në Stomatologji” dhe “Udhëzuesin për hartimin e punimit të diplomës”, asistojnë studentin për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij, bazuar në temën e përzgjedhur apo të dhënat që nevojiten .</p> <p><i>(Evidenca nr.16.Udhëzues për punimin e temës së diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në “Rregulloren e përgjithshme të KUR”, “Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjeksore”, “Rregulloren e programit të studimit Msc në Stomatologji”, i ndryshuar”, në përfundim</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*(Pratras)*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

38



	të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.		
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	KUR me Vendim Senati nr. 19, datë 01.08.2017 ka miratuar “Rregulloren e Kolegjit Universitar “REALD”, ku në <i>Kreun VIII</i> , Provimet dhe diplomimi i studentëve, <i>Neni 65</i> , “Pajisja me diplomë” përcakton qartë procedurën që në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kolegji Universitar “REALD” ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin e përcaktuar, i cili u verifikua në sekretari gjatë vizitës. Informacioni ruhej në regjistrat e furnizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar “REALD” ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. KUR ka miratuar me Vendim Senati Nr.39 datë 10.09.2020 “Rregulloren e programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave “ në “Stomatologji”, ku në Nenin 18, “Provimi përfundimtar”, përcaktohet mbrojtja e diplomës sipas krediteve të përcaktuara në planin mësimor. Sipas planint mësimor diploma mbrohet me mikrotezë dhe ka 15 kredite. Departamenti ka përgatitur një udhëzues për hartimin e punimit të temës së diplomës</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi III.6

**Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**


**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*



Web site: [www.asca.al](http://www.asca.al)




<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>KUR dhe Departamenti i Stomatologjisë ka vendosur në dispozicion të studentëve dhe stafit pedagogjik salla leksioni me projektorë për dhënien e njohurive teorike, një laborator stomatologjik për kryerjen e laboratorëve, klinikë stomatologjike me 5 shtretër për praktika profesionale, si dhe kishte kontrata bashkëpunim me 13 klinika stomatologjike private, të përshtatshme për kryerjen e praktikës laboratorike dhe praktikës profesionale.</p> <p><i>(Evidenca nr.31. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me klinikat dentare për kryerjen e praktikës profesionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka marrëveshje bashkëpunimi me klinikat stomatologjike vendase (Vlorë dhe Tiranë) dhe të huaja (Universitetin Katolik të Mursias – UCAM, Spanjë), nëpërmjet të cilave bën të mundur realizimin e praktikave profesionale cilësore, me qëllim përfutimin e njohurive dhe kompetencave profesionale në fushën e stomatologjisë, dhe përgatisë studentët për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>(Evidenca nr.57. Marrëveshje bashkëpunimi me UCAM-Pgo)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Bazuar në “Planin mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Stomatologji” miratuar me Vendim nr. 39 datë 10.09.2020 të Senatit Akademik, dhe “Rregullores së Fakultetit të Shkencave Mjekësore”, miratuar me Vendim nr.19 datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Neni 29-30, praktikat profesionale, zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe detyrimisht nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Bazuar në Urdhërin Nr. 2 datë 20.01.2023 “Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinike, në programin e integruar të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji, pika 2-3-4 përshkruan procesin e pajisjes të studentit me Librin e Praktikës Profesionale, cdo faqe firmoset cdo ditë nga mjeku stomatolog mbikqyrës, dhe dorëzohet në fund të praktikës koordinatorit të praktikës, i cili pas vlerësimit e dorëzon në Departamentin e Stomatologjisë. Praktika profesionale zhvillohet në vitin e fundit dhe ka 14 kredite (ECTS).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	(Evidenca – dokumenta shitesw: Urdhërin Nr. 2 datë 20.01.2023 “Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikën mësimore, laboratorike e klinike, në programin e integruar të studimit “Master I Shkencave “ në “ Stomatologji.”)			
<b>Konkluzione</b>	Në programin e studimit MSc në Stomatologji, KUR ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve. Kolegji Universitar “REALD” në bashkëpunim me klinikat stomatologjike vendase (Vlorë dhe Tiranë) dhe të huaja ( Universitetin Katolik të Mursias – UCAM , Spanjë), bën të mundur realizimin e praktikave profesionale cilësore, qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale dhe përgatitur për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga pedagogë me eksperiencë pedagogjike dhe klinike, dhe përgjithësisht kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion (<i>Stafi akademik i angazhuar ne Msc. Stomatologji, 2018-2019 deri ne vitin aktual 2022-2023</i>).për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Msc në Stomatologji janë angazhuar staf akademik për pesë vite akademike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik 2018- 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 1 PAE dhe 12 PAK (8 % /92 %);</li> <li>2. Për vitin akademik 2019- 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 1 PAE dhe 12 PAK ((8 % /92 %);</li> <li>3. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 2 PAK (82% / 7 %):</li> <li>4. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 26 pedagogë nga të cilët 20 PAE dhe 6 PAK (76 % / 24 %):</li> <li>5. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 27 pedagogë nga të cilët 25 PAE dhe 2 PAK (92 % / 8 %):</li> </ol>																																																						
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<table border="1" data-bbox="539 1361 1359 1776"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2018-2019</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>4</td> <td>7</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	1	-	-	-	-	2	-	1	-	Prof. Asoc.	1	1	1	1	1	2	1	2	-	2	Dr./PhD.	-	4	-	3	2	-	4	4	7	-
Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023																																														
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																													
Prof.Dr.	-	1	-	-	-	-	2	-	1	-																																													
Prof. Asoc.	1	1	1	1	1	2	1	2	-	2																																													
Dr./PhD.	-	4	-	3	2	-	4	4	7	-																																													

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



Msc.	-	6	-	8	6	-	13	-	17	-
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>12</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>20</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>2</b>

GVJ konstatoi se ka pedagogë që formimi i tyre profesional nuk përputhet me lëndët që ata zhvillojnë. Kështu pedagog me formim biologji zhvillon lëndë mjekësore si imunologji, apo staf akademik me formim infermier zhvillon lëndët radiologji dhe traumatologji. *GVJ rekomandon që Institucioni duhet të vazhdojë përpjekjet për rekrutimin e personelit të specializuar në fushën e stomatologjisë.*


Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion (Ngarkesa e oreve ne auditor e stafit te angazhuar ne Msc. Stomatologji, 2018-2019 deri ne vitin aktual 2022-2023) mbulimi i ngarkesës mësimore rezulton si më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAK
2018-2019	7 %	93 %
2019-2020	7 %	93 %
2020-2021	90%	10 %
2021-2022	88 %	12 %
2022-2023	94 %	6 %

Nga tabela rezulton që për 2 vitet e para akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, *nuk* është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, gjë që është përmbushur gjatë tre viteve të tjera akademike.

Nga shqyrtimi i sylabuseve të hedhur në sistem (Evidenca nr. 8. Sylabuset stomatologji viti I,II,III,IV,V) titullarët e lëndëve rezultojnë si më poshtë:

*Prutius*





Viti shkollor	Nr. lëndëve	Titullarë lënde Profesorë	Titullarë lënde Dr. Shkencash
I	15	13	2
II	12	7	5
III	11	2	9
IV	17	6	11
V	4	1	3

Nga tabela më sipër rezulton se titullarët e lëndëve plotësojnë në shumicën e rateve kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 59, Pika 6.  
*GVJ rekomandon që institucioni duhet të punojë të plotësojë kërkesat e ligjit.*

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit.  
Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Msc në Stomatologji, gjatë 3 viteve të fundit nuk ka ndryshuar, pra ka patur qëndrueshmëri. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis PAE dhe administratorit të Kolegjit Universitar “REALD”.  
*(Stafi akademik i angazhuar ne Msc. Stomatologji, 2018-2019 deri ne vitin aktual 2022-2023))*


**Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Kolegji Universitar “REALD” ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në “Rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore” të miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik. Në *Nenin 31*, përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv nga njësi bazë drejt njësisë kryesore, andej drejt Rektorit.  
Kërkesat për punësim miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi Administrimit, pastaj lajmërimi bëhet publik. Administratori i kolegjit ngre komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e personelit akademik. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik.  
*(Evidenca nr. 18. Rregullore e zyres se Burimeve Njerezore)*

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

44




	<i>(Evidenca nr. 62. Praktikë rekrutimi e stafit akademik)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se Kolegji Universitar “REALD” ka vendosur në dispozicion të kryerjes së programit mësimor MSc në Stomatologji laboratorë të ndryshëm profesional (laborator i protezave klinika dentare) dhe salla leksionesh, të cilët mirëmbahen nga personeli ndihmës akademik të përshtatshëm.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Kolegji Universitar “REALD” mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Msc në Stomatologji. Në tabelat përmbledhës 2, 4, 5, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative. Të dhënat ruhen në letër dhe në formë statistikore. Nga ana tjetër, GVJ nuk evidentoi mekanizma të vlerësimit të performancës në kuadër të promovimit të personelit akademik. <i>GVJ sugjeron që institucioni të vazhdojë të fuqizojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të	Institucioni, për realizimin e praktikës profesionale dhe temave të diplomave të studentëve dhe veprimtarive të tjera kërkimore shkencore, ka nënshkruar një sërë kontratash me institucione arsimore dhe shëndetësore publike dhe private.  Lista e institucioneve partnere të vëna në dispozicion për personelin dhe studentët konsiderohet mjaft pozitive nga GVJ. Ajo ndihmon të realizohen praktikat profesionale, punimin e diplomave dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Praktika*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	(Evidenca nr. 92. Tabelat permbledhese per Aneks-RVB per programin Master Shkencor nw Stomatologji tab 6)		
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar në marrëveshjet dypalëshe që Kolegji Universitar “REALD” ka me klinikat stomatologjike private, është përcaktuar roli mbikqyrës nga personeli në klinikat pritëse, në përbushje të detyrimeve përfundimtare të praktikës bazuar në programin mësimor. Bazuar në Urdhërin Nr. 2 datë 20.01.2023 “Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinikë, në programin e integruar të studimit “Master i Shkencave në “ Stomatologji”, pika 3 përshkruan se cdo faqe e Librit të Praktikës Profesionale firmoset cdo ditë nga mjeku stomatolog mbikqyrës. (Evidenca – dokumenta shtesë: Urdhërin Nr. 2 datë 20.01.2023 “Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinikë, në programin e integruar të studimit “Master i Shkencave “ në “ Stomatologji.)		
<b>Konkluzione</b>	Personeli akademik efektiv dhe më kontratë që mbulon programin e studimit MSc në Stomatologji, <b>përbush KRYESISHT kërkesat ligjore</b> të kornizës rregullatore për IAL, dhe jo të gjithë kanë kualifikimin e duhur profesional e të posaçëm akademik, në përputhje me fushën e programit, lëndën apo praktikën profesionale që do të mbikqyrë, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Njësia bazë vendos kritere për personelin akademik që nevojitet, përzgjedhja e personelit bëhet përmes konkursit, por duhet bërë përpjekje për përthithje të më shumë profesionistëve të kualifikuar, sepse programi MSc në Stomatologji ka shumë lëndë specifike profesionale. <u>GVJ sugjeron që institucioni të vazhdojë të fuqizojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik</u>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
		X	

#### Standardi IV.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking. Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyje hidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Këtë vit akademik institucioni ka zgjeruar kapacitetin pritës me ambiente të reja (kati -1) në të njëjtën godinë. Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundëson demonstrimin më video të leksioneve të ndryshme. Personeli akademik ka kompjuter personal me lidhje internet, që bën të mundur edhe zbatimin e metodave të mësimdhënies në distancë përmes google classroom. KUR ka vënë në dispozicion të procesit mësimor 2 laboratorë dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve. <i>(vizita në ambiente).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të</p>	<p>Institucioni disponon laboratorë mësimorë mjekësore dhe kabinete në funksion direkt të zhvillimit normal të programit mësimor Msc në Stomatologji, si: 2 laboratorë profesionalë,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Pratrus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>laboratori i anatomisë, fizikës, informatikës dhe kimisë. Në laboratorin dentar studentëve iu mundësohet që të realizohet pjesa e paraklinikës, të modelojnë dhëmbët, të realizojnë punime stomatologjike në fantomë dhe të realizojnë pjesën praktike për mbarimin e punimeve protetike të ndryshme. Ushtrimet klinike realizohen në Klinikën stomatologjike duke iu mundësuar studentëve që të vëzhgojnë rastet e ndryshme sidomos ato nga implantologjia, si dhe të kryejnë ndërhyrje stomatologjike të gradës së lehtë, në pacientë.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video projektor dhe me pajisjet e tjera të nevojshme.</p> <p><i>(vizita e ambienteve).</i></p> <p><i>(Evidenca nr.55: Laboratorët në IAL)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit.</p> <p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit KUR ka në zbatim marrëveshje bashkëpunimi me 13 klinika dentar.</p> <p><i>Nga sa më sipër, <u>GVJ sugjeron</u> që të vazhdojë procesi i përmirësimit të kapaciteteve infrastrukurore dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka marrëveshje bashkëpunimi me 13 IAL dhe 13 klinika stomatologjike private, që së bashku më kapacitetet infrastrukurore të tij, garanton mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për praktikat profesionale. KUR ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mjeksisë Tiranë, i cili ka në strukturën e tij dhe Klinikën Stomatologjike Universitare, që është vlerë e shtuar në marrëveshjen dypalëshe. <u>GVJ sugjeron</u> që në marrëveshjet për kryerjen e praktikave profesionale të specifikohen më qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e mjekut stomatologji mbikqyrës.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabura*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	<i>(Evidenca nr. 31: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me klinikat dentare për kryerjen e praktikës profesionale)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Kolegji Univeritar "REALD" vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme, për realizimin e procesit mësimdhënës, si dhe të programit të formimit praktik, në bashkëpunim me 13 IAL dhe 13 klinika stomatologjike private, përtej faktit që ka edhe 1 klinikë stomatologjike në ambientet e tij.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që në marrëveshjet për kryerjen e praktikave profesionale të specifikohen më qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e mjekut stomatologji mbikqyrës.</i></p> <p><i>Nga sa më sipër, GVJ sugjeron që të vazhdojë procesi i përmirësimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Kolegji Universitar "REALD" ka në bibliotekën e tij 932 tituj librash fizikë në fushën e shkencave mjekësore, dhe një listë të gjatë tituj librash të aksesueshëm në bibliotekën on-line në platformën freebooks 4doctors dhe www.Freemedicaljournals.com.</p> <p>Çdo student ka akses ndaj çdo libri në letër apo on-line të nevojshëm për programin e studimit Msc në Stomatologji. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<i>(Evidenca nr. 66. Biblioteka online - Lista e librave të disponueshëm në Bibliotekën e IAL, (Evidenca nr. 8. Syllabuset)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Në rregulloren e NJSBC është e përcaktuar që çdo fillim viti njësia bazë përgjegjëse për programin mësimor përditëson literaturën mbi të cilën përgatitet syllabusi dhe zhvillohet lënda. <i>(Evidenca nr. 12. Rregullore e NJSBC)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës të Kolegjit Universitar “REALD” vërejmë se është në dispozicion dhe aksesohet nga çdo student sipas nevojës. Biblioteka disponon rreth 20 vende leximi dhe vende interneti të pajisura me kompjutera. Biblioteka disponon 2500 botime/titujsh librash profesional. Staf i akademik dhe studentët dispononin adresë të brendshme email-i.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka një fond fizik me 932 tituj në fushën e shkencave mjekësore, tekste mësimore që mbulojnë dhe programin MSc në Stomatologji, si edhe revista dhe botime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në bibliotekë arkivohen kopjet e revistës së botuar nga ana e institucionit dhe periodikë të tjerë <i>(vizita e ambienteve)</i> . <i>(Evidenca nr. 66. Biblioteka online – Lista e librave të disponueshëm në Bibliotekën IAL)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Kolegji Universitar “REALD” ka Bibliotekë në ambientet e tij, dhe ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë, për studentët e MSc në Stomatologji në bibliotekën online në platformën <a href="http://www.freebooks4doctors.com">www.freebooks4doctors.com</a> , <a href="http://www.freemedicaljournals.com">www.freemedicaljournals.com</a> .
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka on-line që ka Kolegji Universitar “REALD” është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. <i>(vizita e ambienteve)</i> .
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*(Pretura)*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Biblioteka është e hapur cdo ditë nga 8.00 deri në orën 16.00. Institucioni nuk ka punonjës të veçantë për bibliotekën.</p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka monitoron fondin e librave fizikë të bibliotekës, si dhe fondin e borimeve në platformën on-line <a href="http://www.freebooks4doctors.com">www.freebooks4doctors.com</a>, të cilat pasurohen në mënyrë periodike bazuar në kërkesat e personelit akademik dhe njësive kryesore. KUR nuk ka një raport për plotësimin e nevojave të studentëve për literaturë shtesë, bazuar në kërkesat e këtyre të fundit. Bazuar në deklaratimet e studentëve dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, ata shprehen pozitivisht për ndihmen dhe mbështetjen e stafit akademik në sigurimin e teksteve, leksione apo literature ndihmese që ju nevojitet gjatë vitit akademik. <i>(takimi me studentët).</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Msc në Stomatologji përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar, fond fizik por edhe akses në platformën <a href="http://www.freemedicaljournals.com">www.freemedicaljournals.com</a>, në mbështetje të mësimdhënie. Gjithashtu, KUR ka bibliotekën e tij, që përdoret nga studentët në orarin e mësimdhënies, dhe pa kufizim ndaj titujve shkencorë. <u>KUR sugjerohet që të ketë evidencë më të plotë të përdorimit të bibliotekës, titujve të librave sipas programit të studimit dhe plotësimin e nevojave të studentëve, si dhe punonjës të dedikuar për bibliotekën.</u></i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p><b>X</b></p>	

**Standardi IV.4**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

*Prusha*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që përcjellë studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. KUR ka një databazë elektronike ku mbahet gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MASR. Gjithë informacioni administrohet nga Sekretaria Mësimore, që funksionon bazuar në “Rregulloren e sekretarisë mësimore” miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 19: “Rregulloren e sekretarisë mësimore” miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në KUR ka sistem të brendshëm menaxhimi administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. KUR i mban të dhënat në dy formate: dosje fizike dhe version elektronik. Informacioni i verzionit elektronik administrohet bazuar në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” miratuar me Vendim Nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik dhe “Rregullore e standartizimit të procedurave për hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar” miratuar me vendim Nr. 36 datë 01.06.2020 të Senatit Akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 20: “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” miratuar me Vendim Nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik,</i></p> <p><i>Evidenca nr. 21. “Rregullore e standartizimit të procedurave për hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar” miratuar me vendim Nr. 36 datë 01.06.2020 të Senatit Akademik).</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabh...*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit bazuar në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” miratuar me Vendim Nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik. Gjithashtu, KUR ka databazë për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për studentët, në rrugë elektronike, në gjuhën shqipe dhe italiane, që i nështrohet rregullave të mësipërme. (Evidenca nr. 20: “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” miratuar me Vendim Nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka platformën e integruar <a href="http://www.unirelad.edu.al">www.unirelad.edu.al</a> që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. KUR i mundëson cdo personeli dhe studenti postën elektronike: <a href="mailto:emër.mbiemër@unireald.edu.al">emër.mbiemër@unireald.edu.al</a>. GVJ evidenton si praktikë të mirë ngritjen e një sistemi të tillë manaxhimi që u mundëson studentët për marrjen e informacionit të duhur për vlerësimin etyre apo informacione të tjera gjatë zhvillimit të programit mësimor. Në të njëjtën kohë ky është prej kushteve të plotësuara nga rekomandimet e mëparshme.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Institucioni përmes sistemit të menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, si dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Komunikimi midis stafit akademik studentë realizohet nëpërmjet e-mail, platformës <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> i cili siguron komunikim interaktiv midis studentëve dhe pedagogëve apo platforma on line Goole clasroom, për të cilin janë hartuar dhe udhësuesit përkatës. (Evidenca nr. 48: Google Classroom Manuali student, Evidenca nr.49. Google Classroom Manual pedagogu) (Evidenca nr.50. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio).(Takimi me studentwt )</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit</p>	<p>Institucioni ka krijuar infrastrukturën për monitorimin e e aktivitetit akademik dhe administrativ apo raportimin e brëndshëm që realizohet nëpërmjet komunikimit me emalin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

*Practus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	brenshëm zyrtar <a href="mailto:emer.mbiemer@unireald.edu.al">emer.mbiemer@unireald.edu.al</a> [takimi me stafin drejtues dhe studentë, pedagogë]  Institucioni disponon faqen e tij të internetit <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> ] e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Informacionet në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen, strukturën/organigramën përditësohen dhe publikohen në faqen e universitetit. Cdo informacion që lidhet me programin e studimit personelin akademik dhe aktivitete që kryen KUR, publikohen në faqen e internetit <a href="http://unirelad.edu.al/en/homepage">http://unirelad.edu.al/en/homepage</a> , në tre gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe, dy të tjerat italiane dhe angleze.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar "REALD" disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, elektronik dhe fizik, i rregulluar me vendim të Senatit Akademik. Ky sistem përdoret për administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit MSc në Stomatologji. Faqja internetit e KUR është në 3 gjuhë të huaja, por në brendësi materialet informuese nuk janë të gjitha në gjuhën italiane dhe angleze, por vetëm në shqip.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të	Menaxhimi financiar i Institucionit është i lidhur me aktivitetin e bizneseve, pjesë e shoqërisë themeluese. Financat e institucionit administrohen nga Bordi i Administrimit.  Referuar Statutit të KUR ( <i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD</i> ) institucioni çdo vit harton buxhetin bazuar në propozimet e njësisë dhe strukturave të kolegjit. GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna mbi procedurën e hartimit të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

*Prusha*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>buxhetit, alokimin dhe realizimin e tij në nivel institucional dhe të programit të studimit. Nga takimi me përfaqësuesit e Bordit, u deklarua se ky proces realizohet. <i>(takim me ZBNJ &amp; ZF).</i></p> <p>Kolegji Universitar “REALD” përmes Bordit të Administrimit, harton raport financiar të kostove të programit të studimit MSc në Stomatologji. Sipas raportit të BA, kosto për një student në MSc Stomatologji është 17500 Euro. Gjithashtu, në raportin financiar, sigurimi i të ardhurave për zhvillimin e programit, mbështet në 3 burime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tarifat e shkollimit,</li> <li>• projekte të përbashkëta ,</li> <li>• investime nga veprimtaria e biznesit e shoqërisë themeluese “ESKELD”.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Referuar Vendimit nr. 4 datë 25.04.2020 të Bordit të Administrimit “Për trajtim të studentëve me status të vecantë dhe miratimin e bursave” GVJ konstatoi se institucioni ndjek politikën e dhënies së bursave në nivelin 100% për studentët me note mestare 10, dhe 50% për kategoritë në nevojë dhe studentët me aftësi ndryshe. <i>(Evidenca nr. 33. Vendimit nr. 4 datë 25.04.2020 të Bordit të Administrimit “Për trajtim të studentëve me status të vecantë dhe miratimin e bursave”)</i></p> <p>Në raportin financiar të përgatitur nga Bordi i Administrimit, për financimin e programit të studimit Msc në Stomatologji, janë të përcaktuar zërat e shpenzimeve si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mësimdhënie – 10%;</li> <li>• kërkim shkencor – 10%;</li> <li>• zhvillimin e personelit – 10%;</li> <li>• infrastrukturën – 10%;</li> <li>• paga personeli – 50%.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” si pjesë e subjektit juridik SHPK ESKELD, kryen auditim financiar periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, të kërkuar sipas ligjit, në mbyllje të çdo viti financiar. Përdorimi i fondeve ka shkuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditorë, shtimit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prutina*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

55




	<p>titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimit të stafit akademik të kualifikuar, financimit të veprimtarive shkencore, por kërkohet informacion të detajuar për shpërndarjen e fondeve sipas zërave të caktuar. Institucioni kryen audite financiare në zbatim të kuadrit ligjor financiar në fuqi në RSH.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e brendshme të KUR, njësitë bazë dhe ato kryesore vihen në dijeni mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. KUR është një institucion jopublik i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifatat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit), të ardhurat nga projektet me IAL të tjera investime nga veprimtaria e biznesit të shoqërisë themeluese/ kompania mëmë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” duke qenë pjesë e subjektit juridik SHPK ESKELD, por edhe nga analiza financiare e veprimtarisë së tij, garanton qëndrueshmërinë financiare.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takim me drejtuesit u deklarua se institucioni është me fitim, dhe investimet i bazojnë në studimin e tregut të punës, kërkesat në rritje për stomatologë për shkak të rritjes së kërkesave për kujdes stomatologjik, por edhe për shkak të kthimit të kujdesit stomatologjik në turizëm shëndetësor, duke përmbytur dhe misionin e KUR për të shërbyer vendit në plotësimin e nevojave për stomatolog.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Universitar “REALD” garanton financimin dhe mbështetjen financiare për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit MSc në Stomatologji, si dhe mbështetjen e studentëve në praktikatat e tyre profesionale. Sugjerohet që KUR të rrisë buxhetin e dedikuar për ngritjen profesionale të personelit akademik si dhe për kërkimin shkencor.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1


Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUR është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e tij në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e kolegjit. Gjatë vizitës dy ditore përveç takimit me stafin, nga dokumentacioni u vlerësua se Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim apo kalim në Kolegjin Universitar "REALD", ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.  <i>(Evidencën nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL, Evidencën nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të	Politikat e Kolegjit Universitar "Reald" garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë studentë, duke informuar studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prusha*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme. Duke u bazuar në të dhënat e marra në takimin e GVJ dhe në Rregulloren e Përgjithshme të IAL, neni 69, studenti ka të drejtë të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e parapara me Statut. Po ashtu, studenti përdorë pajisjet, materialet e ndryshme klinike e ato laboratorike, bibliotekën e Kolegjit, gjithmonë duke u bazuar në planprogram. Studenti ka të drejtë të përfitojë bursë, të shprehë mendimin e tij/saj apo të ankohet në rast të shkeljes së rregullave dhe standardeve akademike.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL. Kreu VI, "Transferimi, ekuivalentimi dhe ndërrimi i formës së studimeve", Neni 54-55-56.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Vendimin Nr.01 datë 08.01.2021 " Për miratimin e kriterëve të të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022 – 2023" Institucioni publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve <i>(faqja e internetit KUR)</i>. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, notës mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Vendimeve të Senatit Akademik. Institucioni publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore.</p> <p><i>(Evidenca nr. 9. Rregullore e programit të integruar Master i Shkencave në Stomatologji- miratuar me Vendim nr. 39 dt. 10.09.2020 te Senatit Akademik);</i></p> <p><i>(Evidenca nr.35. Vendimin Nr.01 datë 08.01.2021 " Për miratimin e kriterëve të të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022 – 2023" i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve);</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së</p>	<p>Institucioni informon përmes posterave dhe takimeve në shkollat e mesme me qëllim që maturantët të njihen</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabura*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

58




<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>paraprkishtë me programet e studimit dhe kriteret e pranimit që ofron KUR, si dhe t’iu jepet mundësia për tu regjistruar. Publikimi i kriterëve për regjistrim behët nga ana e institucionit një vit në avans.</p> <p><i>(Evidenca nr. 74. Kalendar për informimin e nxënësve maturanhtë.);</i></p> <p><i>(Evidenca 75. Poster për informimin e maturanhtëve mbi programet e studimit që ofron IAL);</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në takim me Grupin e Ekspertëve, studentët deklaruan se informohen në fillim të çdo viti akademik në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe studentët rezultoi se Fakulteti në bashkëpunim me Këshillin Studentor organizon aktivitete informuese për maturanhtët e shkollave jo vetëm të Vlorës, por edhe të rretheve të tjera. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Programin e Integruar të Nivelit të Dytë “Master i Shkencave në Stomatologji”, të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar “REALD”, neni 67, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve” si dhe Nenin 76 “Programet e integruara të ciklit të dytë”, organizimi i tyre, dhe hyrja e studentëve në program bazohet në legjislacionin në fuqi. Senati Akademik ka marrë Vendimin Nr.01 datë 08.01.2021 “ Për miratimin e kriterëve të të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022 – 2023”, ku kriter është nota mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.</p> <p><i>(Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD);</i></p> <p><i>(Evidenca nr.35. Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve);</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në Vendimin Nr. 6/1 datë 12.06.2022 të Senatit Akademik “Për rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, në Kolegjin Universitar “REALD”, në Programin e integruar Master i Shkencave në Stomatologji, janë miratuar 80 kuota, nga të cilat janë planifikuar, 1 kuotë për student me statusin e jetimit, 1 kuotë persona me aftësi të kufizuar, 1 kuotë romë+ ballkano egjiptian.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabur*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<i>(Evidenca nr.1 – dokumenta shitesë. Vendimin Nr. 6/1 datë 12.06.2022 të Senatiti Akademik “Për rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Bazuar në Statutin e KUR, çdo vit akademik, për të ndjekur programin e integruar të ciklit të II-të në “Stomatologji” pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Presheva, Bujanovci, Medvegja, Mali i Zi, Italia dhe nga vende të tjera të BE, pasi kandidatët kryejnë procedurën e njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në Vendimin Nr. 6/1 datë 12.06.2022 të Senatitit Akademik “Për rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, në Kolegjin Universitar “REALD”, në Programin e integruar Master i Shkencave në Stomatologji, janë miratuar 80 kuota, nga të cilat janë planifikuar, 1 kuotë për student Kosova, 1 kuotë për student nga Maqedonia Veriut.</p> <p><i>(Evidenca nr.1 – dokumenta shitesë. Vendimin Nr. 6/1 datë 12.06.2022 të Senatiti Akademik “Për rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023)</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Kandidati fitues ka të drejtë të ndjekë studimet në Programin e Integruar të ciklit II në “Stomatologji”, për të cilin aplikoi nëse regjistrohet në Sekretarinë Mësimore brenda afateve të parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij duke përfshirë edhe politikat ndihmëse/ bursat. Institucioni ju ofron bursa studentëve ekselence me notë mesatare 10 (e plotë), studentët e komunitetit rom-egjyptin dhe me aftësi të kufizuara (gjysëm burse).</p> <p><i>(Evidenca nr.33. Vendimin i Bordit Administrativ Nr. 4 datë 25.04.2022 “Për trajtimin e studentëve me status të vecantë dhe miratimin e bursave)</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar “REALD” përmes Senatiti Akademik ka hartuar, ndjek e zbaton politika dhe procedura për pranimin e studentëve, përzgjedhjen e tyre, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MSc në Stomatologji. Institucioni ka</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Praktika*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	vendime për pranimin e studentëve nga trojet shqiptare, si dhe me status të vecantë, duke ofruar edhe bursa.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi V.2


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në web faqen e Kolegjit Universitar Reald ( <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> ), institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në web faqe përshkruhet procedura e kalimit nga një vit në tjetrin/përmbushja e 30 ECTS. Gjithashtu në rregulloren e përgjithshme të IAL, përshkruhen kriteret e kalimit në vitin pasardhës, sipas prgramit përkatës, <i>Neni 62</i> "Kriteret e kalimit në vitin pasardhës.  (Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL. Kreu VIII, "Provimet dhe diplomimi i studentëve", Neni 62.)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në rregulloren e përgjithshme të IAL, përshkruhen kriteret e kalimit në vitin pasardhës, sipas prgramit përkatës, <i>Neni 62</i> "Kriteret e kalimit në vitin pasardhës, studenti Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë. Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë Studenti kalon nga viti i trete në vitin e katërt, kur ka siguruar të paktën 110 kredite nga viti i parë, i dytë dhe i tretë Studenti kalon nga viti i katërt në vitin e pestë, kur ka siguruar të paktën 150 kredite nga viti i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt. Studenti i vitit të fundit që në përfundim të provimeve të vitit rezulton me 30 kredite të pashlyera, ka të drejtë t'i likujdoje ato

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<p>në një periudhë të caktuar nga dekanati, përpara sezonit të diplomimit. Studenti që shlyen këto detyrime, lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës. Në rast të kundërt, i lind e drejta e shlyerjes së tyre në sezonin e riprovimeve të vjeshtës.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL. Kreu VIII, "Provimet dhe diplomimi i studentëve")</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën nr. 4 / <i>Rregullore e përgjithshme, Kreu VII Kontrolli i Dijes, Neni 57/ Sistemi i Vlerësimit/</i> institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1 deri te 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë), në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër) në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL. Kreu VIII, "Provimet dhe diplomimi i studentëve")</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulat e çdo programi studimi. Sekretaria mësimore është e detyruar t'i përcjellë me shkresë të veçantë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e provimit të formimit ose mbrojtje e tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave. Përgjegjësi i departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngrë një komision ad hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, ose provimin e formimit e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet përgjegjësit të departamentit. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë, për fitimin e diplomës parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabhua*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

62




	<p>pavarur. Për 36 fitimin e diplomave të ciklit të dytë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studenti. Drejtuesit e temave të diplomës propozohen nga departamenti sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe miratohen nga Rektori. Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të përmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i fakultetit me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe përbëhet nga 5 (pesë) vetë. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar dhe material kundrejt Kolegjit, është kusht paraprak për kryerjes e mbrojtjes së tezës së diplomës. Përgjegjësi i departamentit i përcjellë dekanit të fakultetit listën e studentëve të diplomuar. Dekani nëpërmjet një shkrese e përcjellë këtë listë Rektoratit për të mundësuar pajisjen e të diplomuarit me kartonin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe Rektori. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Kolegjit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 6. Udhëzuesi për punimin e temës së diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Kolegji universitar “REALD”, publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Këshillimi akademik që ofron Kolegji ka për synim të orientojë dhe ndihmojë studentët mbi mundësitë e paraqitura, duke vlerësuar alternativat e mundshme.</p> <p><i>(Evidenca nr. 74. Kalendar për informimin e nxënësve maturantë);</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 75. Poster për informimin e maturantëve për programet e studimit që ofron IAL KUR)</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prabura*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

63




<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar "REALD" ka vendosur në dispozicion të studentëve të programit të studimit Msc në Stomatologji informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve. KUR ka të publikuar në faqen e institucionit informacionin, por edhe në fillim të vitit u jepet studentëve nga pedagogu lëndës, mbi: kriteret e kalimit nga një vit në tjetrin, ecurinë e lëndës, procedurat për marrjen e diplomës. KUR kryen fushatë informim të maturantëve rreth programeve të studimit që ofron IAL.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë vizitës dy ditore, studentët deklaruan se informohen në mënyrë të detajuar për përmbajtjen e programit të studimit, për lëndët dhe modulet që kanë për të zhvilluar, orët totale të mësimin si ato në auditor dhe ato në praktikën klinike, strukturën e orëve mesimore, mësimet praktike të detyrueshme etj. rradhën e zhvillimit të lëndëve, vitin apo semestrin përkatës, detyrimet që kanë për pjesëmarrje, pikët që duhet të realizojnë për të qënë kalues, literaturën kryesore dhe ndihmëse dhe mënyrën e sigurimit të saj. <i>(Takimi me studentët në ambjentet e KUR)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Për studentët, ndiqet procedurë informimi për titullarin e lëndës, stafin mësimdhënës që do të zhvillojë lëndën, eksperiencën e tij shkencore e klinike, titullin dhe gradën shkencore që ai ka. CV të përditësuar janë publikuar jo vetëm në faqen e internetit por në çdo lëndë / modul.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Dokumentacioni i programit përmban informacion mbi mundësitë e punësimit. KUR në bazë të marrëveshjeve të lidhura me insitucionet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me klinikat private, i krijon mundësinë studentëve që pas përfundimit të ciklit të studimit të punësohen në disa prej tyre.</p> <p>( <a href="https://unireald.edu.al/pse-unireald/">https://unireald.edu.al/pse-unireald/</a>)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Referuar takimit me studentët, rezulton se studentët janë të informuar mbi procesin mësimor, infrastrukturën e fakultetit dhe ambientet ku do të realizohet procesi mësimor dhe praktikat profesionale.</p> <p><i>(Takimi me studentët në ambientet e KUR)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Komunikimi zyrtar realizohet nëpërmjet adresave zyrtare të institucionit, çka e lehtëson këtë komunikim. Institucioni ka një sistem informacioni të efektshëm për ruajtjen e informacioneve personale të studentëve nga sekretaritetë mësimore dhe kryesekretaret.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Universitar "REALD" vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Msc në Stomatologji, informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i></p> <p><i>Studentët informohen për lëndët, përmbajtjen e tyre, asistencë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës për mundësitë e punësimit, dhe çdo informacion ju përcillet përmes emailit personal.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi V.4**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, mban informacion të plotë mbi numrin në hyrje, në dalje dhe larguar të studentëve të tij. Çdo student i regjistruar në KUR, gjendet në Regjistrin bazë të studentëve ku janë shënimet për ecurinë e tyre gjatë studimeve.</p>														
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>(Evidenca nr.80, Të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar 5 vitet e fundit)</p> <p>Të dhënat statistikore administrohen nga Sekretaria mësimore, e cila ruan evidencat dhe dosjet e plota të çdo studenti. Kjo u evidentua dhe në takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore. Në statistikat e vëna në dispozicion të GVJ, është kryer edhe analiza mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe ecuria e tyre gjatë studimeve. Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion numri i studentëve për këtë program studimi për pesë vitet akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="571 1093 1369 1512"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>63</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>76</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>151</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>(Evidenca nr.79. Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar largimet para përfundimit të programit në vitet e fundit)</p> <p>(Evidenca nr. 81. Të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje e studentëve në tre vitet e fundit)</p>	Viti akademik	Të regjistruar	2018-2019	10	2019-2020	2	2020-2021	0	2021-2022	63	2022-2023	76	<b>Totali</b>	<b>151</b>
Viti akademik	Të regjistruar														
2018-2019	10														
2019-2020	2														
2020-2021	0														
2021-2022	63														
2022-2023	76														
<b>Totali</b>	<b>151</b>														

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




	<i>(Evidenca nr. 92 - Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - MSc. Stomatologji . Viti akademik 2021-2022)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me sekretarinë mësimore evidentoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbarëvajtjen e të dhënave të ecurisë së studentëve në programin e studimit dhe atë meanë të regjistrave të notave dhe të frekuentimit, regjistrin të gjeneraliteteve, dosjeve të studentëve, përgjatë 5 viteve të ciklit të studimit. (rregullorja e sekretarisë), (vizita në mjediset e fakultetit). Dosjet e studentëve ruhen në sekretarinë mësimore (shembull dosje studenti). KUR ka database ku ruhen në format elektronik të dokumentacionit dhe të dhënat personale të studentit në gjuhën shqipe dhe italiane.</p> <p><i>(Evidenca nr.89- 90. Database për ruajtjen në formatin elektronik të dokumentacionit dhe të dhënave personale të studentit në gjuhën shqipe dhe italiane);</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 19. Rregullore e sekretarisë në KUR);</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>Duke iu referuar RVB dhe takimit të GVJ u konfirmua se Arkivi kompjuterik garanton sigurinë e informacioneve dhe qasjen e lehtë të të dhënave në rast nevojë. Në Kolegj mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti bëhen në përputhje me Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Edhe studentët u shprehën të kënaqur me sistemin e menaxhimit <i>(takimi me studentët)</i>.</p> <p><i>(Evidenca nr.20. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, miratuar me Vendim nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik )</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të	<p>Në nivel universiteti funksion Zyra e Karrierës, e cila ka funksionale një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Rol kryesor në këtë drejtim luan koordinatori i programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 14. Rregullore e Këshillit të Karrierës, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prubus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



përmirësimit të këtyre treguesve.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar "REALD", përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Karrierës, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X

### Standardi V.5


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në takimin me studentët dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet që përfshihen studentët në organet kolegjiale të KUR. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, Neni 10, "Përbërja e Senatit Akademik, pika 2.e- Një përfaqësues të studentëve, rezulton se studentët janë pjese aktive dhe e rëndësishme e organeve përfaqësuese dhe administrative. <i>(Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Siç u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbështetje të vazhdueshme nga stafi akademik dhe administrativ për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë, si dhe cdo shqetësim që kanë dëgjohej dhe delegohet. <i>(Takim me studentët)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	Studentët japin mendime pranë Departamentit për procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit, cilësinë e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prubus*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifatat e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikat, sezonet e provimeve etj. <i>(Takim me studentët)</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga takimi me studentët <i>(Takim me studentët)</i> , por edhe nga rishikimi i dokumentacionit, KUR i jep mundësinë studentit që të japë mendimin e tij rreth barazisë së vlerësimit të provimit. Gjithashtu, studentit i jepet mundësia e ankimimit për rezultatin e provimit, përmes një procedure të rregullur, të paraparë në Rregulloren e Përgjithshme të IAL, Neni 59, “Ankimimi për rezultatin përfundimtar”.  <i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL)</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar “REALD” përfshin dhe angazhon studentët në Senatitn Akademik, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Një përfaqësues i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik. Studentët e kanë të garantuar në rregulloren e IAL procesin e ankimimit për rezultatin e provimit.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni, në organikën e tij ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës, zyrë e cila në funksionin e saj ka pikërisht informimin e studentëve. Përveç kësaj zyre, në funksion të informimit të studentëve është edhe koordinatori i programit. Institucioni ka hartuar edhe rregulloren e këshillimit të karrierës në shërbim të studentëve. Megjithatw, KUR nuk disponon procedura e struktura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p> <p><i>(Evidenca nr. 14. Rregullore e Zyres se Këshillit të Karrierës)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>KUR nuk disponon procedura e struktura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët. Këtë rol e kryen sekretaria mësimore e cila ndjek ecurinë e studentëve gjatë vitit akademik. Studentët marrin në sekretari të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumente që iu nevojiten. Sic u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbeshteje të vazhdueshmë nga stafi akademik dhe administrative për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në rregulloren e përgjithshme të KUR, si strukturë ekziston zyra për këshillimin e karrierës. Zyra e Karrierës synon lehtësimin e lidhjeve midis karrierës akademike dhe mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar në KUR dhe promovimin e tyre në institucionet, klinikat, laboratorët apo kompanitë, të cilat janë të interesuara për punëmarrës. Përftimi i dijes, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut arrihet përmes qasjes e kombinimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke i adaptuar, dhe duke i bërë të mundshme për studentët që të identifikojnë dhe përdorin përvojën e tyre, njohuritë që më së miri i avancojnë ata në procesin mësimor dhe i bëjnë të gatshëm për punësim.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme e IAL);</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 14. Rregullore e Zyres se Këshillit të Karrierës)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prutras*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

70



<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald”, nuk ka numër të lartë studentësh e për rrjedhojë është lehtësisht i gjurmueshëm punësimi i tyre nga ana e Institucionit. Studentët e KUR, në një numër të konsideruar janë të punësuar në institucione, publike, private dhe vetëpunësim. Ky informacion u bë i ditur nga takimi i GVJ me përfaqësuesit e Institucionit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Referuar gjetjeve dhe konstatimeve nga ana e grupit të vlerësimit të jashtëm rezulton se për Standardin V.6, KUR nuk disponon procedura e struktura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët. Shumica e veprimtarive janë të organizuar me komisione ad-hoc dhe nuk përfaqësojnë struktura të përhershme.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>KUR ka të ngritur në nivel institucional Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e cila funksionon në bazë të statutit dhe rregullores. Kolegji Universitar “REALD” ka miratuar “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, ku përcaktohet që cdo fillim viti akademik vlerësohen dhe përmirësohen metodat mësimdhënëse, sipas lëndëve dhe fushës së studimit. Gjithashtu, KUR ka hartuar udhëzuesit përkatës për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe studimit, si Google classroom dhe programin OBS për regjitrin video dhe audio të leksioneve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD);</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme e IAL).</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 12. Rregullore e NJSBC)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC përpqet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë të cilat kanë nevojë të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. KUR ka Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë bazuar në “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, detyrë e së cilës është monitorimi përmes mekanizmave të ndryshëm, si anketa e zhvilluar me studentët, të metodave të mësimdhënies nga ana e personelit akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 12. Rregullore e NJSBC)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>KUR ka zhvilluar mekanizma që garantojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet NJSBC. NJSBC e kryen këtë objektiv përmes zhvillimit të anketës dhe plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime. Pyetësorët analizohen dhe NJSBC përgatit raport vjetor të anketimit të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 23. Raport vjetor pwr NJSBC 2020-2021)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin</p>	<p>NJSBC bën publike rezultatet e vlerësimit vjetor në web faqen e KUR <a href="http://www.unirelad.edu.al">www.unirelad.edu.al</a>, i cili është i aksesueshëm nga</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al





dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	studentët dhe publiku. Në këtë drejtim KUR duhet të ndjekë politika të qarta të cilat realizohen nëpërmjet procedurave periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	KUR nga vlerësimet e kryera përmes anketimeve të studentëve, bën të mundur të nxjerrë në pah praktikatat e mira të përmenduar nga studentët, çfarë motivon personelin akademik të përmirësojë metodat e mësimdhënies. Këto procese të realizohen duke përfshirë të gjithë kontribuesit e institucionit që të ndihmojnë në krijimin e kulturës së cilësisë në nivel institucional.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar "REALD" ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), që garanton dhe promovon cilësinë e mësimdhënies, si dhe ka udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave për monitorimin e cilësisë.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	KUR ka një strukturë të quajtur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazuar në "Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë" miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", <i>Kreu X, 2</i> , bazon punën e saj në statutin e institucionit dhe të gjithë akteve rregullatorë të brendshëm. ( <i>Evidenca nr. 12. Rregullore e NJSBC</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe	Kolegji Universitar "REALD" ka miratuar "Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë" me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, dhe bazuar në këtë rregullore ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

73




<p>zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>është struktura përgjegjëse për menaxhimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. NJSBC ka disa mekanizma për përmirësimin e cilësisë, ku një nga kryesorët është përfshirja e studentëve në proces por edhe mbledhja e opinionit të tyre përmes anketimit studentor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KUR përmes NJSBC përdor instrument sasior dhe cilësor për përmirësimin e cilësisë.  <u>Instrumentat cilësor</u> përfshijnë anketimin e studentëve, pyetorët për pedagogët, formularin e vlerësimit të pedagogëve.  <u>Instrumentat cilësor</u> përfshijnë tryezat e hapura, rishikimin e literaturës për lëndën.  KUR ka të angazhuar përmes NJSBC edhe një ekspert të jashtëm, i cili merret me analizimin e të dhënave të anketimit, me qëllim shmangien e biasit në rezultatet e nxjerra.  <i>(Evidenca nr. 22. Plan pune pwr vitin akademik 2021-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>KUR përdor tregues sasiorë dhe cilësorë, bazuar në anketime dhe tryeza të hapura (fokus grupe), për mësimdhënien, dhe kërkimin shkencor bazuar në numrin e publikimeve të stafit pedagogjik. NJSBC përgatiti raportin vjetor ku nxjerr rezultatit e anketimeve apo vazhgimeve të ndryshme.  <i>(Evidenca nr. 23. Raport vjetor pwr NJSBC 2020-2021)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Universitar "REALD" ka hartuar dhe zbaton rregulloren përkthëse dhe procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në përgjithësi, dhe të MSc në Stomatologji në vecanti, ku ka ngritur NJSBC si strukturë e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NJSBC është përgjegjëse për zbatimin e gjithë instrumentave për matjen sasiorë dhe cilësorë të cilësisë në mësimdhënie, dhe rekomandimeve përkthëse. <u>GVJ rekomandon</u> që NJSBC të mundësojë intervista me studentët që janë diplomuar dhe janë në punë, me qëllim marrjen e opinionit të tyre për pikat e dobëta që mund të ketë programi i studimit përkthës.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Prutina*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>KUR ka një procedurë formale e të dokumentuar, për propozimin dhe miratimin e programit të studimit të ciklit të dytë MSc në Stomatologji. Procedura filloi me propozimin e njësive bazë dhe të njësive kryesore, të cilat kaluan me Vendim Nr.39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik të KUR, dhe Vendimin Nr.10 datë 11.09.2021 të Bordit të Administrimit.</p> <p>Ky proces i është bërë me dije Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresë Nr.79 Prot. Datë 31.03.2021, dhe aprovimin nga MASR me Urdhër Nr. 259, datë 19.07.2021. Vendimi për riorganizimin e programit nga MSC në Stomatologji dhe proteza dentare, në Msc në Stomatologji, është bazuar në argumentimin e mos zbatimit të programit të mëparshëm për arsye burokratike nga Universiteti i Foggias.</p> <p><i>(Evidenca nr. 37. Urdhër i MASR nr. 259, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët studim të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave " në "Stomatologji dhe proteza dentare" në program studim të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave " në "Stomatologji" në Kolegjin Universitar "REALD".</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 36. Shkresa e dërguar MASR për riorganizimin e programit të integruar Msc. Në Stomatologji.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të</p>	<p>NJSBC në KUR përgatit raportet e vlerësimit dhe planin e punës për aktivitetet e saj, me detyra konkrete, ku përfshihen: emërtimi, përkrahimi detyrës, periudha e kryerjes, rezultati i pritshëm. Përmes planit të punës, NJSBC adreson problematikat dhe mangësitë e vërejtura, si dhe motivon personelin akademik për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafu», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-48423

E-mail: info@ascal.al

*Prusha*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC.</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Raport vjetor për NJSBC 2020-2021, Evidenca nr. 22. Plan pune për vitin akademik 2021-2022.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, njësia duhet të marrë rol kryesor jo vetëm në hartimin e planit të punës apo zhvillimin e pyetësorëve standartë por të përfshijë edhe metoda të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve të përafrohen realitetit në të cilin ndodhet institucioni. <i>(Evidenca nr. 82. Model pyetësori për studentët, vlerësim i studentit për pedagogun).</i></p> <p>Në takimin me anëtarët e NJSBC, u deklarua se për shkak të situatës nga pandemia, zyra e ka patur të vështirë të koordinojë veprimtaritë e veta prej vitit 2020. Në vitin 2022-2023 aktiviteti i NJSBC ka qënë normal. NJSBC merr informacion të përvitshëm për provimin e shtetit dhe nivelin e kalueshmërisë së studentëve të diplomuar në KUR.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazuar në “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe të studentëve, të personelit akademik përmes formularit të pedagogut. NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e vet duke u bazuar më së shumti në rekomandime dhe plane pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara.</p> <p><i>Në këtë kuadër, GVJ rekomandon përmirësimin e proceseve punës të cilat lidhen me analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave që kanë nevojë të përmirësohen.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Practica*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar "REALD" përmes strukturës së NJSBC, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit Msc në Stomatologji përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorat të cilësisë së mësimdhënies, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, dhe rezultateve të synuara të të nxënit. Sugjerohet që KUR të kryejë anketime edhe me ish-studentët (alumni) për të marrë feed-back në lidhje me programin mësimor dhe aftësimin e stomatologëve në fund të programit të studimit.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Institucioni ka eksperiencë në disa procese akreditimi gjatë këtyre viteve të funksionimit të tij. Nëpërmjet akteve të tij si statut, rregullore, garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë.</p> <p>Përfshirja e studentëve në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit <i>nuk rezulton në nivelin e duhur</i> pasi vetë studentët nuk janë të informuar mbi ndryshimet e fundit të kryera në vitin 2020 (<i>takimi me studentët</i>)</p> <p>Përbërja e strukturës së NJSBC siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, ku sipas "Rregullores të sigurimit të brendshëm të cilësisë" miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Neni 4, "Struktura e NJSBC", përbëhet nga 5 anëtarë, 3 nga të cilët</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


77




	janë pjesë e personelit akademik, 1 përfaqësues i studentëve dhe 1 ekspert i jashtëm.. Ndërsa ekspertët e jashtëm janë përfshirë në studimin e tregut të punës e vlerësuar kjo pozitivisht nga ana e GVJ. (Evidenca nr. 12. Rregullore e NJSBC)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e KUR. Njësia bazë ka marrë rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit. Nuk u evidentuan raste të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	KUR ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik me kontratë. Në këtë drejtim kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit.  NJSBC harton planin e veprimtarive ku parashikohen angazhime të njësisë në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në institucion. Në përgjithësi njësia harton raportime periodike të punës
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është kryesisht had-hoc por evidentohen përpjekje të cilat mund të jenë pikënisje në të ardhmen për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me strukturat e institucionit në mënyrë që veprimtaritë e sigurimit të cilësisë mos shihen si detyrë vetëm e NJSBC por si proces në të cilin integrohen dhe përfshihen të gjithë aktorët e institucionit. “Rregullorja e sigurimit të brendshëm të cilësisë” miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, respekton integritetin akademik dhe shmang cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose	Ndërkohë vërehen shembuj pozitivë të angazhimit të aktorëve të jashtëm të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si p.sh hartimi i studimit të tregut të punës, siguron

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al





Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	përfshirjen e aktorëve të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.  Eksperti i jashtëm është pjesë aktive e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit përmes anketimeve, analizimit të rezultateve dhe shkruarjes së raporti.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Kolegji Universitar "REALD" përmes NJSBC përfshin njësitë bazë, njësitë kryesore, personelin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit, dhe informon studentët dhe palët e interesuara duke bërë publike rezultatet.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Kolegji Universitar "REALD" ka publikuar në mënyrë transparente dhe publike politikat, strategjinë dhe veprimatrinë e NJSBC. Gjithashtu, KUR ka të publikuara në web faqen e tij <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> edhe raportet e NJSBC për çdo vit mësimor. Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar mjaft informacione që informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në faqen e internetit të institucionit ka informacion të limituar në lidhje me veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë për institucionin në tërësi dhe për programin e studimit Msc në Stomatologji në veçanti.  (Faqja zyrtare e KUR: <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> )  Në KUR respektohet liria dhe etika akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Institucioni ka "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale".

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” i shoqëron rezultatet e vlerësimit me plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Plani i masave përgatiet si “Plan-masash për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit”. Një pjesë e informacioneve që lidhen me sigurimin e cilësisë janë kryesisht informuese ndërsa sikundër është deklaruar në takime, institucioni është i hapur për këdo për të dhënë informacione të detajuara në institucion në versionin e printuar apo elektronik. GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale. <i>(Vizitë te zyra e burimeve njerëzore KUR)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” monitoron zbatimin e masave në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, duke përgatitur “Relacion mbi zbatimin e detyrave në planin e masave”.</p> <p>GVJ ka vërejtur se në raportimet që janë kryer nga IAL nuk është evidentuar analizë e detajuar vlerësimi e cila në përfundim të shoqërohet me plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Konstatimi se institucioni nuk ka hartuar vlerësime, raportime, që analizojnë impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit vazhdon të qëndrojë edhe në këtë proces vlerësimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ identifikoi veprimtari dhe informacione të limituara që lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Gjatë takimit me NJSBC, u deklarua se IAL organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. <i>(Takimi me NJSBC)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji Universitar “REALD” ka politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Proceset, veprimtaritë dhe rezultatet e tyre për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	janë publike në ww b faqen e institucionit: <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> . <i>GVJ sugjeron që institucioni të përgatisë raportime që analizojnë impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Stomatologji”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Partneritetet me një sërë punëdhënësish dhe Klinika Dentare në vend dhe jashtë, të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale, si dhe mundësi punësimi të studentëve pas diplomimit;
2. Qëllimi i Kolegjit Universitar REALD për ndërkombëtarizimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke e angazhuar stafin akademik të huaj (italianë);
3. Përqindje e lartë e studentëve të diplomuar, që kanë marrë provimin për licencë profesionale nga komisioni shtetëror;
4. IAL ka ngritur laborator dentar modern dhe klinikë dentare për zhvillimin e seminareve dhe praktikave profesionale;


**b. Pikat e dobëta:**

1. Institucioni ka nevojë për rekrutimin e personelit të specializuar në fushën e stomatologjisë; **(Standardi IV.1-2)**
2. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik janë akoma të pakonsoliduara; **(Standardi IV.1-6)**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-48423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

*Prutina*



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





3. Personeli akademik efektiv dhe më kontratë, që mbulon programin e studimit MSc në Stomatologji, jo të gjithë kanë kualifikimin e duhur profesional e të posaçëm akademik, në përputhje me fushën e programit, lëndën apo praktikën profesionale që do të mbikqyrë; *(Standarti IV.1)*

### Rekomandime

1. KUR të marrë masat për zbatimin e procesit elektronik të sekretimit (kodifikimit) të tezave të provimeve, dhe korrigjimin "blind" të tyre;
2. KUR duhet të bëjë përpjekje për përthithje të më shumë profesionistëve të kualifikuar, në përputhje me fushën e programit, lëndën apo praktikën profesionale që do të mbikqyrë sepse programi MSc në Stomatologji ka shumë lëndë specifike profesionale;
3. Me qëllim të rritjes së cilësisë në mësim dhe të plotësojë kërkesat e ligjit që titullarët e lëndëve të jenë me titullin profesorë, rekomandohet që të rritet numri profesorëve me kohë të plotë dhe të specializuar;
4. GVJ sugjeron që institucioni të vazhdojë të fuqizojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik;
5. GVJ sugjeron që të vazhdojë procesi i përmirësimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies;
6. GVJ sugjeron që në marrëveshjet për kryerjen e praktikave profesionale të specifikohen më qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e mjekut stomatolog mbikqyrës;
7. KUR sugjerohet që të ketë evidencë më të plotë të përdorimit të bibliotekës, titujve të librave sipas programit të studimit dhe plotësimin e nevojave të studentëve, si dhe punonjës të dedikuar për bibliotekën;
8. Sugjerohet që KUR të rrisë buxhetin e dedikuar për ngritjen profesionale të personelit akademik si dhe për kërkimin shkencor;
9. GVJ rekomandon që NJSBC të mundësojë intervista me studentët që janë diplomuar dhe janë në punë, me qëllim marrjen e opinionit të tyre për pikat e dobëta që mund të ketë programi studimit përkatës;
10. GVJ rekomandon përmirësimin e proceseve të punës, të cilat lidhen me analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave që kanë nevojë të përmirësohen;
11. Sugjerohet që KUR të kryejë anketime edhe me ish-studentët (alumni) për të marrë feed-back në lidhje me programin mësimor dhe aftësimin e stomatologëve në fund të programit të studimit;
12. GVJ sugjeron që institucioni të përgadisë raportime, që analizojnë impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë me qëllim përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit;

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences  
"Dentistry"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. Collaboration with several employers and Dentistry Clinics in Albania and abroad, which provide opportunity for doing professional practice, and employment possibility after graduation, as well;
2. Engagement of UC REALD to approach international academic staff (Italian) aiming internationalization of UCR and improvement of teaching and scientific research;
3. High level of graduated students who pass the state exam for professional licence;
4. CUR has established modern laboratory and dentistry clinic in site, for performing professional practice.

**b. Weaknesses:**



1. Institution needs recruitment of specialized personnel in the area of stomatology; (*Standard IV.1-2*)
2. Quality insurance tools in framework of quality improvement and academic staff promotion are not consolidated yet; (*Standard IV.1-6*)
3. Not all academic staff employed and with contract have proper academic and professional specialization according to study program, subject or professional practice; (*Standard IV.1*)

**Recommendation**

1. Institution should plan to implement electronic recording of the exam thesis in order to do "blind" correction of them;
2. College should increase attempt to employ more qualified academic staff, according to study program (stomatology), subject or professional practice;
3. Institution should increase number of a staff employed with academic degree "Professor" in order to improve quality of study program and fulfil law requirements;
4. EEG suggests to institution to continue empowerment of quality insurance tools in framework of quality improvement and academic staff promotion;
5. EEG suggests infrastructure capacity improvement process should continue in function of study program and teaching process;

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



6. EEG suggests that in collaboration agreements for professional practice with other clinics to clearly specify obligations and responsibilities of medical supervisor;
7. College is suggested to keep full evidence of library attendance by students and titles of books according study program, and appoint one dedicated employee for library;
8. It is suggested that College to increase the budget dedicated for professional development of academic staff and for scientific research;
9. EEG recommends that IIQU to make possible interview with graduated and employed students, in order to collect their opinion for weak points of the study program;
10. EEG recommends improvement of working process which are connected with information or data analysis, reporting and proposals/ recommendations to address in the future all problems needed to be improved;
11. It is suggested that College carry out survey with former students (alumni) in order to get feedback regarding study program and capacity building as stomatologist at the end of the study;
12. EEG suggests to institution to prepare reports which analyse impact of activities in framework of monitoring and evaluation of quality in continuous improvement of the study program quality;





## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)